

LIGJ
Nr. 155/2015

PËR LOJËRAT E FATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(ndryshuar me ligjin nr. 140/2016, datë 22.12.2016)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton kategoritë e lojërave të fatit të lejuara, kushtet, kriteret dhe procedurat që rregullojnë këtë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrat, përgjegjësitë dhe bashkëpunimin e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë:

1. Kuadrin e nevojshëm ligjor për mënyrën e organizimit, kushtet e funksionimit të lojërave të fatit dhe lejimin e shoqërive për të ushtruar këtë aktivitet.
2. Mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.
3. Mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë së organizatorëve të lojërave të fatit.
4. Rregullat e përgjithshme për licencimin e lojërave të fatit, pezullimin dhe revokimin e licencës, si dhe autorizimin e veprimtarive të tjera të lidhura me industrinë e lojërave të fatit.
5. Të drejtat dhe detyrimet e operatorëve të lojërave të fatit.
6. Shpërndarjen e të ardhurave nga lojërat e fatit.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Fusha e zbatimit të këtij ligji përfshin:

1. Shoqëritë, që ushtrojnë veprimtarinë e lojërave të fatit, sipas kategorive të parashikuara në nenin 5 të këtij ligji.
2. Shoqëritë, të cilat kanë detyrim të pajisen me autorizim për ushtrim lojërash promovionale të fatit.
3. Shoqëritë, të cilat importojnë dhe tregtojnë pajisje për lojëra fati dhe pjesë këmbimi të tyre.
4. Shoqëritë programuese të programeve *software* të lojërave të fatit, nëpërmjet të cilave zhvillohet aktiviteti i lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë.
5. Çdo shoqëri apo person që do të japë me qira/huapërdorje ambiente ku do të ushtrohet aktivitet lojërash fati dhe që duhet të marrë miratim paraprak nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Aplikim” është kërkesa që i drejtohet autoritetit të parashikuar në ligj për t’u pajisur me licencë për organizimin e lojërave të fatit, sipas dispozitave të këtij ligji.

2. “Autoritet i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit”, (referuar si “AMLF”) është personi juridik publik, në varësi të Ministrisë së Financave, i cili është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit.

3. “Bankë e nivelit të dytë” ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. “Bast” është vendosja e një çmimi ose shume parash nga një lojtar për rezultatin e një ngjarjeje që do të ndodhë në të ardhmen.

5. “Baste për gara në pistë” është vendosja e basteve për rezultatin e garave me kuaj ose me qen, të administruara në hipodrom.

6. “Baste sportive” janë bastet e vendosura për ngjarjet sportive dhe lojërat sportive, të cilat do të ndodhin në të ardhmen dhe që nuk përfshihen garat e pistave.

7. “Bingo televizive” është loja, e cila bëhet publike nëpërmjet medias televizive dhe nga hedhja e shortit dalin aq numra sa nevojiten për të pasur një fitues. Në këtë lojë, pjesëmarrësit me biletat e blera të hedhura në treg nga organizatori përmbajnë një grup numrash, pjesë përbërëse të një grupi tjetër të caktuar numrash.

8. “E drejta për të organizuar lojëra fati” është e drejta që i jepet një shoqërie sipas licencës së dhënë në përputhje me këtë ligj për të organizuar lojëra fati brenda qëllimit, mënyrës dhe në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë ligj.

9. “Fond garancie” është shuma, e cila depozitohet në një bankë të nivelit të dytë nga organizatori i lojërave të fatit në favor të AMLF-së, si garanci për përmbushjen e detyrimeve periodike ndaj AMLF-së apo për t’u përdorur për raste të tjera, të parashikuara nga ky ligj.

10. “Fondi i ngurtësimit” është shuma, e cila ngurtësohet nga organizatori i lojërave të fatit në një bankë të nivelit të dytë, me seli në Republikën e Shqipërisë, në favor të Ministrisë së Financave, si garanci për fituesit e lojërave të fatit.

11. “Gjeneruesi rastësor i numrave (*Random Number Generator/RNG*)” është një pajisje e certifikuar, e cila, bazuar në modelet rastësore, gjeneron alternativa numrash apo simbolesh rastësore, tërësisht të pavarura dhe të paparashikueshme, të cilat vendosen në mënyrë të barabartë brenda balancave të caktuara.

12. “Hipodrom” është një vend apo një stadium për organizimin e garave në pistë.

13. “Hotele me 5 yje” janë hotelet, të cilat kanë marrë certifikatën për këtë klasifikim nga institucionet ndërkombëtare akredituese.

14. “Importues/tregtues” i makinave të lojërave të fatit dhe pjesëve përbërëse për to është personi juridik shqiptar, i cili pajiset me autorizim dhe të cilit i lejohet të importojë dhe/ose të tregtojë në Republikën e Shqipërisë mjete apo pjesë këmbimi për lojëra fati.

15. “Kazino” është një zonë e veçantë për zhvillimin e lojërave të fatit, ku lojtarëve u ofrohet mundësia për të luajtur me mjetet e lojërave të fatit, si makina të tipit slot, video-lotari ose makina elektronike, me shumë lojtarë, si dhe tryeza loje të quajtura “lojëra live”.

16. “Licencë” është akti administrativ për dhënien e së drejtës për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit, me anë të të cilit organizatori i lojërave të fatit ushtron veprimtarinë sipas kategorisë përkatëse.

17. “Lojtar” është personi që merr pjesë të luajë në kategoritë e lojërave të fatit, sipas rregullave të përcaktuara në ligj dhe në rregulloren e lojës së fatit.

18. “Lojërat e basteve sportive” janë lojërat, në të cilat pjesëmarrësit (lojtarët) hamendësojnë rezultatet e ngjarjeve të ndryshme të propozuara nga operatori dhe rrethanat e fitimit apo humbjes nuk

duhen të njihen paraprakisht prej askujt dhe duhet të jenë të natyrës që as lojtari dhe as operatori nuk mund të kenë ndonjë ndikim në to; dhe ku shuma e fituar apo e humbur të varet nga shuma e luajtur nga lojtari për çdo kombinim dhe nga koeficienti përkatës për çdo ngjarje në veçanti (bastet sportive, bastet për kuajt , garat me qen, bastet mbi ngjarjet e propozuara nga operatori etj.).

19. “Lojëra fati” janë lojërat e përcaktuara në këtë ligj, ku pjesëmarrësve në këmbim të një shume të paguar u jepet mundësia e fitimit në para, sende apo të drejta të tjera, ku faktori fat ose ndonjë ngjarje tjetër e pasigurt ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe është përcaktues si në fitimin, ashtu edhe në humbjen e pjesëmarrësve në secilën lojë.

Nuk vlerësohen lojëra fati:

a) konkurset që zhvillohen në bazë të njohurive të pjesëmarrësve, ku fituesi merr një çmim të caktuar, të vendosur për këtë qëllim;

b) pagesat që bëhen nga sigurimi i jetës ose llojet e tjera të sigurimit, nëpërmjet tërheqjes me short të biletave, të emetuara për këtë qëllim.

20. “Lojë fati promovionale” është loja nga subjektet që nuk ushtrojnë veprimtari në fushën e lojërave të fatit, që promovon produkte ose shërbime, në të cilën pjesëmarrësit mund të përfitojnë çmime apo bonuse.

21. “Lojërat në kazino” janë lojërat e luajtura nga lojtarët në makinën e kazinove ose njëri lojtar kundër tjetrit në tavolina të lojërave me gogla, me karta ose me zara, në përputhje me rregullat e lojës në kazino. Përveç lojërave të luajtura në tavolina, në ambientet e kazinosë mund të luhen edhe lojërat e fatit me makina të tipit slot dhe VLT.

22. “Lojëra elektronike në distancë” janë lojërat e fatit *on-line* ku lojtarët marrin pjesë nëpërmjet përdorimit të komunikimit në distancë, internetit, telefonit por pa u kufizuar vetëm në to. Lojërat luhen në faqet zyrtare të internetit (*web*) të subjekteve të licencuara për kategorinë “Loja elektronike në distancë”.

23. “Lotari Kombëtare” është shoqëria e licencuar për të organizuar të gjitha lojërat e lotarisë, që mund të ofrohen vetëm nga mbajtësi i licencës për Lotari Kombëtare.

24. “Makina elektronike” është pajisja elektro-mekanike, elektronike ose pajisje të ngjashme, e cila lejon një ose më shumë lojtarë të luajnë pa ndërhyrjen e njeriut, ku, përmes pagesës së një shume të caktuar, lojtarët kanë të drejtë të gjenerojnë fitime.

25. “Makinë slot” është një makinë/pajisje loje elektro-mekanike ose elektronike, nëpërmjet së cilës vetëm një lojtar mund të lejohet të luajë në të njëjtën kohë, e cila ka një mekanizëm gjenerues të numrave të rastësishëm, të instaluar në makinë, që përcakton rezultatin e lojës dhe ku me pagesën e një shume të caktuar lojtarët kanë mundësinë për të fituar në varësi të fatit.

26. “Mjetet e lojërave të fatit” janë mjetet elektrike, elektronike ose mekanike, që përdoren ose synohet të përdoren për të luajtur lojëra fati dhe funksionimi i të cilave ka një ndikim në rezultatin e lojës.

27. “Organizator” është personi juridik shqiptar, i cili licencohet dhe të cilit i lejohet të ushtrojë veprimtari në fushën e lojërave të fatit, në zbatim të dispozitave të këtij ligji.

28. “Pajisje basti” janë pajisjet kompjuterike dhe elektronike, bileta ose çdo gjë tjetër, e përdorur për zhvillimin e lojërave për baste.

29. “Pajisje lotarie” janë pajisje kompjuterike, përfshirë terminalin e VLT-së, bileta ose çdo gjë tjetër, të përdorur për zhvillimin e lojërave të lotarisë.

30. “Pikat e basteve” janë zonat/sallat specifike të organizuara ku bëhen pagesat për bastet bazuar në ligj dhe në rregullat e lojës, si dhe të miratuara nga AMLF-ja.

31. “Programet kompjuterike për lojëra basti” janë programet e ideuara dhe të ndërtuara nga shoqëritë e licencuara nga AMLF-ja për të ofruar shërbimin e basteve sportive.

32. “Programues i licencuar i lojërave të fatit” është personi juridik shqiptar, të cilit i lejohet nëpërmjet autorizimit të ofrojë programe kompjuterike për ushtrimin e aktivitetit të lojërave të fatit, për baste sportive.

33. “Pronar përfitues” është individ, që zotëron në nivel fundor aksione në personin juridik, që aplikon për licencë për të drejtën për të organizuar lojëra fati apo në secilin prej zinxhirit të personave juridikë që rezultojnë nga verifikimi i të drejtave mbi aksionet në personin juridik që aplikon për licencë.

34. “Publicitet” është çdo formë njoftimi për promovimin e lojërave të fatit, qëllimi i dukshëm i së cilës është dhënia e informacionit publikut në të gjitha format e mundshme të aksesueshme nga publiku.

35. “Regjistrimi i lojtarëve” është regjistrimi i të dhënave identifikuese të lojtarit dhe ruajtja e këtij informacioni nga organizatori, për një afat prej 3 (tre) vjetësh.

36. “Resort kazino” është një kompleks kazinosh, i përbërë nga dy ose më shumë kazino, me të paktën 5 hotele me 5 yje të integruara, të cilat kanë marrë certifikatën për këtë klasifikim nga institucionet ndërkombëtare akredituese si dhe infrastruktura të ndryshme ndihmëse (por pa u kufizuar vetëm në to), të tilla si: qendra konferencash, restorante, ambiente argëtuese, ambiente sportive apo që shërbejnë për biznesin, infrastrukturë pushimi dhe akomodimi apo infrastrukturë tjetër, të projektuara për zhvillimin e turizmit.

37. “Rregullore e lojës së fatit” është tërësia e rregullave të propozuara nga organizatori i licencuar i lojës dhe i miratuar nga autoriteti i parashikuar në ligj, ku përcaktohen të drejtat e detyrimit e organizuesit dhe të pjesëmarrësit në lojën e fatit, si dhe kushtet për ushtrimin e lojës së caktuar e rregullat e lojës.

38. “Sistemi Qendror i Monitorimit *On-line*” është sistemi i mbikëqyrjes në distancë dhe në kohë reale të organizatorëve që ushtrojnë aktivitet në fushën e lojërave të fatit nga AMLF-ja, nëpërmjet ngritjes së një infrastrukture teknike dhe kontrollit *on-line* të ushtrimit të aktivitetit të lojërave të fatit.

39. “Tarifë për pajisje me licencë” është pagesa fillestare që bëhet nga shoqëria aplikuese për të marrë një licencë, e cila paguhet në momentin që i miratohet licenca për të ushtruar aktivitet lojërash fati, sipas kategorisë ku ka aplikuar.

40. “Të ardhurat bruto nga loja” është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre.

41. “Transaksionet e dyshimta” janë transaksionet, për të cilat organizatori vlerëson se ekziston një dyshim i arsyeshëm për pastrim parash apo financim të terrorizmit dhe/ose transaksione që përfshijnë fonde të gjeneruara nga aktivitete të paligjshme.

42. “Tryezë loje” është pajisje loje, ku një ose më shumë lojtarë mund të luajnë në të njëjtën kohë, së bashku me shpërndarësin e letrave dhe/ose zarave, që quhet “kupjer”.

43. “Video-lotari” (referuar si “VLT”) është lotaria e luajtur nëpërmjet video-terminaleve, të lidhura me një sistem rrjetesh elektronike, ku rezultati i lojës mbështetet në shansin e prodhuar nga serveri, bazuar në gjenerimin e numrave të rastësishëm.

44. “Zona me rëndësi kombëtare” janë zonat turistike, të cilave, sipas ligjit përkatës të turizmit dhe projekteve të zhvillimit, u është dhënë përparësi zhvillimi dhe investimi në fushën e turizmit.

Neni 5

Kategoritë e lojërave të fatit

Kategoritë e lojërave të fatit, që lejohen të zhvillohen në Republikën e Shqipërisë, për të cilat shoqëritë e interesuara mund të licencohen bazuar në këtë ligj, janë:

- a) baste sportive;
- b) baste për gara në pistë;
- c) kazino/kazino të vendosura në hotele me 5 yje;
- ç) lojë elektronike në distancë;
- d) resort kazino;

- dh) Lotaria Kombëtare;
- e) bingo televizive.

Neni 6

Mbrojtja nga lojërat e fatit

1. Organizatorit të lojërave të fatit i ndalohet të punësojë dhe të lejojë të futen apo të luajnë në mjediset e lojërave të fatit persona nën moshën 21 vjeç.
2. Organizatori është i detyruar që t'i kërkojë dokumentin e identifikimit çdo lojtar që luan në ambientet e lojërave të fatit, në mënyrë që të mos pranojë lojtarë nën moshën 21 vjeç dhe ka detyrimin që të regjistrojë të dhënat identifikuese të lojtarit.
3. Organizatori për kategorinë "Kazino" është i detyruar të mbajë regjistrin e lojtarëve dhe të ruajë të dhënat e regjistruara në të për një afat jo më pak se 3 vjet.
4. Organizatori merr masa të ndalojë për të luajtur në mjediset e lojërave të fatit një person, për të cilin ka një kërkesë me shkrim prej vetë lojtarit apo prej të paktën një prej familjarëve të tij, ku kërkohet moslejimi i këtij personi për të hyrë në mjediset e lojërave të fatit.
5. Kërkesa duhet të depozitohet pranë AMLF-së. AMLF duhet të mbajë një regjistër të personave, për të cilët është kërkuar të mos lejohen për t'u futur në ambientet e lojërave të fatit.
6. Pas marrjes së këtij njoftimi, AMLF-ja njofton të gjitha shoqëritë, që operojnë në fushën e lojërave të fatit, për moslejimin e këtij personi të luajë në këto mjedise. Mbajtja dhe ruajtja e të dhënave identifikuese të lojtarit bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
7. Mosveprimi nga ana e organizatorit, sipas njoftimeve të AMLF-së, sjell për pasojë marrjen e masave administrative ndaj organizatorit, sipas nenit 53, të këtij ligji.
8. Rregullat e mbajtjes dhe funksionimit të regjistrit identifikues të lojtarëve të parashikuar në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, miratohen nga AMLF-ja.

Neni 7

Mbrojtja e lojtarit

(ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 140/2016, datë 22.12.2016)

1. Organizatorët e lojërave të fatit janë të detyruar të vendosin në mënyrë dalluese në ambientet ku luhen lojëra fati mesazhe në lidhje me luajtjen e lojërave të fatit nga lojtarët në mënyrë të përgjegjshme, rreziqet e mundshme të lojërave të fatit, si dhe shanset reale për të fituar.
2. Ndalohen ndërtimi/blerja, marrja/dhënia me qira apo huapërdorje e mjediseve, me fushë veprimtarie lojëra fati, të ekspozuara pranë institucioneve fetare, institucioneve të arsimit parauniversitar dhe institucioneve të arsimit të lartë.
3. Distancat ndërmjet subjekteve të lojërave të fatit nga institucionet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, duhet të jenë jo më pak se 100 metra në vijë ajrore në të gjitha drejtimet. Distancat të llogariten ndërmjet ekstremiteteve më të afërta të dy objekteve. Mënyra e përlllogaritjes së distancave sipas kësaj pike përcaktohet me udhëzim të ministrit të Financave.
4. Brenda datës 31 dhjetor 2018 organizatorët, që ushtrojnë veprimtarinë pranë këtyre institucioneve, duhet të marrin masat për ndryshimin e vendndodhjes. Në rast se brenda kësaj periudhe shoqëritë nuk kanë ndryshuar vendndodhje, AMLF-ja procedon me masa administrative deri në heqjen e licencës.

Neni 8

Ndalimi i nxitjes për të marrë pjesë në lojërat e fatit

1. Ndalohen ofrimi, ndihma ose nxitja e një loje apo e lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Lojërat elektronike në distancë, të parashikuara në nenin 5, të këtij ligji, lejohen të organizohen *on-line*, vetëm pas licencimit të tyre.

3. Në rastet kur shoqëri vendase a të huaja apo persona ofrojnë zhvillimin e lojërave *on-line*, të palicencuara apo në shkelje të dispozitave të këtij ligji, AMLF-ja, nëpërmjet autoriteteve mbikëqyrëse përkatëse, ka të drejtë të kërkojë bllokimin e menjëhershëm të këtyre faqeve të internetit.

Neni 9

Publiciteti i lojërave të fatit

(ndryshuar pika 5 dhe 6 me ligjin nr. 140/2016, datë 22.12.2016)

1. Ndalohet publiciteti për lojëra fati në një mënyrë që shfaqet veçanërisht për të miturit ose që i paraqet lojërat e fatit si zgjidhje të problemeve financiare.

2. Ndalohet publiciteti në median e shkruar, elektronike dhe audiovizive, me përjashtim të buletineve informative të vetë organizatorit të lojës.

3. Në çdo rast, Drejtori i Përgjithshëm i AMLF-së urdhëron organizatorin të heqë nga publikimi çdo material promocional që nuk është në përputhje me këtë ligj apo aktet nënligjore në zbatim të tij. Materialet promociionale lidhur me lojërat e fatit nuk transmetohen në programe radiofonike, televizive apo në materiale të shtypura të destinuar për fëmijë dhe persona nën moshën 21 vjeç.

4. Rregulli i përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, është detyrim si për organizatorët e lojërave të fatit dhe për ofruesit e shërbimeve e botuesit. Kopja e urdhrat të drejtorit të Përgjithshëm i dërgohet për dijeni edhe autoritetit përkatës që mbikëqyr dhe monitoron mediat audiovizive.

5. Ndalohet reklamimi i aktivitetit të lojërave të fatit, në pjesën e jashtme të pikave/sallave të ofrimit të lojërave të fatit për çdo kategori, sipas këtij ligji, me përjashtim të tabelës identifikuese. Formatit dhe përmasat e tabelës identifikuese përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Brenda një periudhe njëmuajore nga hyrja në fuqi e udhëzimit, organizatorët e lojërave të fatit marrin masat për zbatimin e këtij detyrimi. Në rast se brenda kësaj periudhe organizatorët nuk kanë marrë masat për ndryshimin e formatit dhe përmasave të tabelave identifikuese, sipas këtij udhëzimi, zbatohen masat administrative të parashikuara në nenin 53 të këtij ligji.

6. Shoqërive të lojërave të fatit, basteve sportive dhe basteve për garat në pistë u lejohe të reklamojnë aktivitetin e tyre në vendet në të cilat organizohen aktivitete sportive të të gjitha kategorive, përveç aktiviteteve sportive të destinuar për personat nën 21 vjeç. Reklama audiovizive për bastet sportive mund të bëhet vetëm gjatë transmetimit të aktiviteteve sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.

7. Publiciteti në mediat e shkruara lejohet vetëm në shtypin sportiv dhe në faqet sportive të mediave të tjera. Buletinet informativë të organizatorëve nuk përbëjnë publicitet.

KREU II

KRIJIMI, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES SË LOJËRAVE TË FATIT

Neni 10

Krijimi dhe statusi i AMLF-së

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit është institucioni përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së organizatorëve në fushën e lojërave të fatit.

2. AMLF-ja është person juridik publik, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit të Financave.

Neni 11

Struktura dhe organika e AMLF-së

1. Struktura dhe organika e AMLF-së miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Financave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. AMLF-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil.

3. Marrëdhëniet e punës për nëpunësit e AMLF-së rregullohen me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, përveç inspektorëve të cilët, sipas këtij ligji mbajnë armë. Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 12

Financimi dhe buxheti i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

1. AMLF-ja financohet nga të ardhurat e veta, të cilat sigurohen nga pagesat që bëjnë organizatorët e lojërave të fatit, sipas pikës 1, të nenit 14, të këtij ligji, si dhe të ardhurat e siguruar nga vjelja e gjobave dhe kamatëvonesave të vendosura sipas nenit 53 të këtij ligji.

2. AMLF-ja, jo më vonë se tre muaj para fillimit të çdo viti financiar, i paraqet ministrit të Financave planin e të ardhurave dhe të shpenzimeve për vitin e ardhshëm, të shoqëruar edhe me realizimin e pritshëm të këtyre treguesve për vitin në vazhdim. Ministri i Financave miraton planin e shpenzimeve të parashikuara për vitin e ardhshëm.

3. AMLF-ja mban llogari të plota dhe të sakta të shpenzimeve faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.

4. Të ardhurat e siguruar nga vjelja e gjobave dhe e kamatëvonesës derdhen 90 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 10 për qind ngelen në llogari të AMLF-së. Këto të ardhura nga gjobat dhe kamatëvonesat përdoren nga AMLF-ja, për investime, si për: mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit.

5. Të ardhurat e papërdorura nuk transferohen në vitin pasardhës, por derdhen në buxhet si tepriçë nga të ardhurat.

Neni 13

Funksionet e AMLF-së

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit ushtron këto funksione:

a) licencën subjektet që aplikojnë për ushtrim aktiviteti në fushën e lojërave të fatit, sipas kriterëve të këtij ligji;

b) kontrollon dokumentacionin e personave fizikë dhe juridikë, të cilët aplikojnë për t'u pajisur me licencë apo që janë pajisur me licencë, si dhe kërkon dokumente dhe prova shtesë në rastet kur e gjykon të arsyeshme;

c) mbikëqyr dhe kontrollon veprimtarinë e subjekteve, që organizojnë dhe ushtrojnë aktivitetin e lojërave të fatit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin për këtë veprimtari dhe aktet nënligjore në fuqi;

ç) monitoron në distancë dhe në kohë reale subjektet e licencuara të lojërave të fatit nëpërmjet Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line*;

d) vendos sanksione në formën e masave administrative në rastet kur vëren shkelje të dispozitave të këtij ligji;

dh) në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj kontrollon dhe verifikon nëse mjetet e lojërave të fatit janë të certifikuar nga subjekte të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) miraton pajisjet e lojërave të fatit, sipas specifikimeve teknike, të përcaktuara me udhëzim të ministrit të Financave, të cilat janë të pajisura me certifikata nga subjekte të akredituara;

ë) mbikëqyr dhe kontrollon subjektet e pajisura me autorizim për luajtjen e lojërave

promocionale të fatit;

f) mban regjistrin për subjektet, që ushtrojnë këtë veprimtari dhe të sallave të hapura prej tyre në të gjithë territorin e vendit për numrin e automateve/pajisjeve për çdo sallë loje dhe karakteristikat specifike të tyre, numrin e punonjësve dhe kualifikimin përkatës të tyre, numrin e biletave të Lotarisë Kombëtare të hedhura në treg dhe ato të shitura, numrin e shorteve të hedhura nga organizatori i Lotarisë Kombëtare dhe organizatorët e bingos televizive;

g) në rakordim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me drejtoritë rajonale tatimore, verifikon shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe deklarimet mujore të organizatorëve, të parashikuara në pikën 2, të nenit 57, të këtij ligji;

g) kontrollon e verifikon deklarimet e bëra nga organizatorët pranë AMLF-së, në përputhje me detyrimet për deklarim, të parashikuara nga ky ligj;

h) kontrollon dhe verifikon fitimet e organizatorëve nga lojërat.

2. Shtypja dhe prodhimi i biletave për lojëra fati, formati dhe mënyra e emetimit të biletës *on-line* apo forma të tjera të pranimit të pjesëmarrjes në lojën *on-line* bëhen në përputhje me procedurat, afatet dhe formatet e miratuara me udhëzim të ministrit të Financave, sipas llojit të lojës për të cilën do të përdoren.

3. AMLF-ja njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të gjitha të dhënat, që kanë lidhje me tatim-taksat.

Neni 14

Detyrimet e shoqërive të licencuara ndaj AMLF-së

1. Shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit derdhen në llogarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit 3 për qind për qind të të ardhurave bruto nga loja, por jo më pak se 1,5 milionë lekë në vit për secilin subjekt.

2. Mënyra dhe afatet e kryerjes së pagesës përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 15

Raportimi i AMLF-së

1. Drejtori i Përgjithshëm i AMLF-së raporton për veprimtarinë e institucionit që drejton te Ministri i Financave.

2. Drejtori i Përgjithshëm i AMLF-së, brenda tremujorit të parë të çdo viti, dorëzon pranë ministrit të Financave raportin vjetor të veprimtarisë për vitin pararendës si dhe, me kërkesë të ministrit të Financave, raporton për çështje të lidhura me rregullsinë e zhvillimit të veprimtarisë së subjekteve të licencuara në fushën e lojërave të fatit për kontrollet e ushtruara, rezultatet e tyre, si dhe për sanksionet e vendosura.

3. AMLF-ja gjatë vitit i siguron ministrit të Financave çdo informacion që e gjykon të nevojshëm për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit të tregut dhe monitorimit të lojërave të fatit, si dhe për përmbushjen e kompetencave të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 16

Inspektimi

1. Inspektimi i veprimtarisë së çdo organizatori, personi juridik dhe fizik, që zhvillon veprimtari në fushën e lojërave të fatit, kryhet nga inspektorët e AMLF-së.

2. Inspektorët e AMLF-së pajisen me dokument të posaçëm identifikimi. Ata kryejnë inspektim në mjediset, ku personi fizik apo juridik zhvillon veprimtarinë pa e njoftuar paraprakisht ushtruesin e këtij

aktiviteti, për të verifikuar zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij.

3. Çdo person juridik dhe/ose individ, që zhvillon veprimtari në fushën e lojërave të fatit, është i detyruar t'i lejojë inspektorët të kryejnë inspektimin kudo ku ka pajisje të lojërave të fatit, si dhe t'u ofrojë inspektorëve të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar prej tyre.

4. Inspektorët kanë të drejtë, që, në ambientet ku ushtrohet ose dyshohet se ushtrohet aktivitet lojërash fati, të kontrollojnë çdo pajisje, dokument apo objekt tjetër të lidhur me një aktivitet lojërash fatit.

KREU III LICENCIMI I USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË NË FUSHËN E LOJËRAVE TË FATIT

Neni 17

Rregulla të përgjithshme

1. Kushtet për organizimin e lojërave të fatit rregullohen sipas këtij ligji, akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe rregullave të propozuara nga organizatori për çdo lojë dhe bëhen të zbatueshme pasi organizatori të ketë marrë licencën përkatëse.

2. Nuk mund të ushtrohet veprimtari në fushën e lojërave të fatit nga subjekte të palicencuara nga AMLF-ja në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Bastet sportive, bastet për garat në pistë, kazinotë, lojërat elektronike në distancë dhe bingot televizive lejohen të organizohen nga çdo subjekt, që përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, në zbatim të tij, vetëm pasi kanë marrë licencën nga AMLF-ja.

3. E drejta për t'u pajisur me licencë të re për të marrë të drejtën për të organizuar lojëra fati i refuzohet:

a) subjektit që kërkon të pajiset me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, por që ka rezultuar debitor karshi institucioneve shtetërore dhe nuk ka shlyer detyrimet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;

b) subjektit që ka ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë ose anëtarë të organeve drejtuese të veta, individë apo persona që kanë qenë ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë apo anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të lojërave të fatit që rezultojnë debitorë ndaj institucioneve shtetërore.

c) subjektit që ka ortakë/aksionarë, përfaqësues ligjorë ose anëtarë të organeve drejtuese të veta, individë apo persona që kanë qenë ortakë /aksionarë, përfaqësues ligjorë apo anëtarë të organeve drejtuese të subjekteve të lojërave të fatit që rezultojnë të dënuar penalisht me një vendim gjyqësor të formës së prerë për veprat penale të parashikuara në këtë ligj.

4. Autoriteti i autorizuar nga Këshilli i Ministrave për organizimin e garës për përzgjedhjen e subjektit që do të fitojë të drejtën e organizimit të lojërave të Lotarisë Kombëtare zhvillon procedurat e garës dhe lidh kontratën me subjektin që shpallet fitues.

5. Drejtori i Përgjithshëm i AMLF-së miraton dhe lëshon autorizimin për të organizuar lojëra fati promovionale. Loja promovionale organizohet nëpërmjet shitjes dhe tregtimit të mallrave/shërbimeve apo në ndonjë mënyrë tjetër gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, për efekt promovimi ose publiciteti të produkteve ose shërbimeve, për subjektet publike ose private që nuk ushtrojnë veprimtari në fushën e lojërave të fatit. Mënyrat, format, kriteret dhe rregullat për organizimin e lojërave të fatit promovionale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Financave.

6. Për interesa publike dhe duke arsyetuar rast pas rasti interesin publik, Këshilli i Ministrave ka të drejtë të pezullojë për një afat kohor të caktuar procedurat e lëshimit të licencave të reja të subjekteve të lojërave të fatit.

Neni 18

Rregulla specifike

1. Shoqëritë për organizimin e lojërave të fatit regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007, për “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, dhe në organet tatimore, në përputhje me legjislacionin për regjistrimin e subjekteve dhe procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

2. Pas regjistrimit të shoqërisë në QKR, 30 ditë përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së lojërave të fatit, shoqëria paraqet pranë AMLF-së kërkesën për licencim, shoqëruar me të gjithë dokumentacion e kërkuar, sipas dispozitave të këtij ligji për licencim.

3. Shoqëritë për organizimin e lojërave të fatit, sipas kategorive, mund ta ushtrojë veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar zonën dhe kufizimin e adresave sekondare për çdo licencë të miratuar në përputhje me pikën 5, të këtij neni.

4. Pas marrjes së licencës për hapjen e sallave, subjekti bën pranë AMLF-së kërkesë për hapje salle. Pas miratimit nga AMLF-ja, subjekti është i detyruar të regjistrohet në QKR, brenda 7 ditësh nga data e marrjes së miratimit nga AMLF-ja.

5. Organizatorët e lojërave të fatit, në momentin e licencimit dhe gjatë të gjithë afatit të saj, kufizohen si më poshtë:

a) Kazinotë kanë të drejtë të hapin vetëm 1 sallë për ushtrim aktiviteti.

b) Bastet sportive deri në 1000 adresa sekondare. Distancat nga njëra pikë basti te tjetra duhet të jetë jo më pak se 100 metra në vijë ajrore.

c) Çdo subjekt i pajisur me licencë për bastet për garat në pistë ka të drejtën e 1 hipodromi.

6. Organizatori për kazinotë duhet të njoftojë AMLF-në, 10 ditë përpara, për çdo makinë shtesë që vendos në pikë/sallë. Në çdo rast, organizatori për kazino nuk mund të vendosë më pak se 20 makina në secilën sallë. Salla duhet të ketë një sipërfaqe të tillë që secilit automat t’i takojë një sipërfaqe prej 5 m².

7. Organizatori është i detyruar që të monitorohet *on-line* dhe t’i lejojë AMLF-së akses në serverin e tij.

8. Organizatori duhet të njoftojë AMLF-në 30 ditë përpara për mbylljen e çdo salle, ndryshimin e selisë, ndryshimin e personelit apo të numrit të mjeteve të lojërave për çdo sallë, në përputhje me licencën që zotëron.

9. Në sallën e lojërave të fatit mund të ushtrohet aktivitetet vetëm nga një organizator i licencuar vetëm për një nga kategoritë e lejuara për lojëra fati.

10. Organizatorët e lojërave të fatit duhet t’u kthejnë lojtarëve, në formën e fitimit:

a) bingot televizive, jo më pak se 80 për qind të shumës së vënë në lojë;

b) kazinotë, jo më pak se 80 për qind të shumës së vënë në lojë, përveç lojërave *live*, që zhvillohen në tavolina;

c) Lotaria Kombëtare për çdo lotari, jo më pak se 60 për qind të shumës së vënë në lojë. Për rastet kur shuma në dispozicion të lojtarëve nuk u shpërndahet fituesve, ajo mbartet në lotarinë pasardhëse, si shumë në dispozicion të lojtarëve.

11. Shitja, lënia peng, dhurimi dhe çdo formë tjetër e disponimit të aksioneve, asetëve, pasurisë apo makinave të organizatorit të lejuar për zhvillimin e lojërave të fatit bëhen me miratim të AMLF-së. Kjo procedurë, si dhe dokumentacioni i kërkuar përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 19

Afatet dhe tarifat e licencës

1. Afati i licencimit për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit është 10 vjet.

2. Afati i licencës fillon që nga data e lëshimit të saj.

3. Tarifa e licencimit për kategoritë:

a) “Baste sportive dhe baste për garat në pistë”, për të gjithë periudhën e licencimit, është: 200

000 000 (dyqind milionë) lekë. Në këtë tarifë është përfshirë e drejta për të hapur deri në 1000 adresa sekondare në total.

b) “Bingo televizive”, për të gjithë periudhën e licencimit, është 40 000 000 (dyzet milionë) lekë;

c) “Kazino”, për të gjithë periudhën e licencimit, duke filluar nga 1 000 000 000 (një miliard) lekë. Në këtë tarifë është përfshirë e drejta për të hapur vetëm 1 sallë në total.

ç) “Kazino të vendosura në hotelet me pesë yje”, për të gjithë periudhën e licencimit, është 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë;

d) “Resort kazino” për të gjithë periudhën e licencimit është 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë.

dh) “Lotaria Kombëtare”, për të gjithë periudhën e licencimit, duke filluar nga 1 000 000 000 (një miliard) lekë.

e) “Lojëra elektronike në distancë”, për të gjithë periudhën e licencimit, është 200 000 000 (dyqind milionë) lekë.

4. Tarifa e licencës paguhet në shuma të barabarta përgjatë të gjithë afatit të licencimit.

5. Mënyrat dhe afatet për kryerjen e pagesave të tarifave të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

KREU IV ORGANIZIMI I BASTEVE

Neni 20

Kërkesat për të lejuar ushtrimin e veprimtarisë së basteve

1. Asnjë person/shoqëri nuk mund të organizojë dhe/ose të zhvillojë baste, në qoftë se nuk është i pajisur me licencë dhe nuk plotëson detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, në zbatim të tij.

2. Të gjitha bastet, të cilat nuk vendosen në kohë reale në serverin qendror të organizatorit për ngjarje sportive të papërsëritshme apo të zhvilluara në kohën kur rezultati i ngjarjeve sportive është pothuajse i vendosur dhe i përcaktuar dhe nuk rezultojnë si baste të vëna në serverin qendror të monitorimit *on-line* janë të ndaluara.

3. Bastet lejohen të vendosen vetëm në pikat e basteve të miratuara nga AMLF-ja dhe të pajisura me adresa sekondare nga QKR-ja për zhvillimin e këtij aktiviteti.

4. Pikat e basteve duhet të respektojnë distancën nga insitucionet përkatëse sipas nenit 7 të këtij ligji.

5. Pikat e basteve duhet të plotësojnë kushtet dhe standardet minimale të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave.

Neni 21

Pagesa për ushtrim veprimtarie për bastet

Personi juridik mund të ushtrojë veprimtarinë për lojërat e fatit për baste kur ka plotësuar kriteret e përcaktuara në nenet 22 dhe 24, të këtij ligji, dhe ka bërë pagesat në përputhje me nenet 14 dhe 19 të këtij ligji.

Neni 22

Kriteret për lejimin e organizimit të basteve

1. Kriteret, që duhet të plotësojë shoqëria për t’u lejuar për organizimin dhe ushtrimin e lojërave të fatit për baste sportive dhe/ose baste për gara në pistë janë, si më poshtë vijon:

a) të jetë shoqëri aksionare, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, me objekt veprimtarie lojëra fati;

- b) të paraqesë certifikatën e regjistrimit me numrin unik të identifikimit të shoqërisë;
- c) të ketë kapitalin themeltar të shoqërisë jo më të vogël se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë;
- ç) të depozitojë dokumentacion të plotë në lidhje me aksionarët e shoqërisë, nga i cili të dalë qartë struktura e pronësisë së subjektit, informacioni për kapitalet dhe interesat e aksionarëve në shoqëri të tjera, si dhe të identifikohet deri në fund individi/individët përfitues;
- d) të paraqesë për miratim rregulloren e lojës, sipas nenit 23, të këtij ligji;
- dh) të ketë një marrëveshje paraprake për të bashkëpunuar me njërën nga bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave;
- e) të ketë depozituar fondin e garancisë në favor të AMLF-së për shlyerjen e detyrimeve karshi këtij të fundit në përputhje me pikën 2, të nenit 47, të këtij ligji;
- ë) të paraqesë genplanin e ambienteve ku do të ushtrojë aktivitetin, sipas të cilit vërtetohet distanca nga institucionet e parashikuara në pikën 2 dhe 3, të nenit 7, dhe distancat nga pikat e tjera të basteve sipas nenit 18/5, paragrafi i dytë, i këtij ligji;
- f) të paraqesë ekstraktin nga QKR-ja, ku të vërtetohet se shoqëria është me status aktiv, nuk është në procedura likuidimi, vërtetim nga gjykata që shoqëria nuk është në procedura falimentimi, si dhe vërtetimet e mëposhtme, të lëshuara nga organet kompetente, sipas juridiksionit territorial për subjektin organizator:
- i) se subjekti nuk është i dënuar penalisht dhe në ndjekje penale;
 - ii) se subjekti nuk është në gjykim për vepra penale;
 - iii) vërtetim nga Zyra e Përmbartimit Gjyqësor se subjekti nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera;
- g) aplikantët/administratorët dhe aksionarët e shoqërisë të dorëzojnë në momentin e aplikimit dëshmi penaliteti, vërtetime nga gjykata që nuk janë në proces gjyqësor dhe nga prokuroria që nuk janë në procedim penal si dhe vetëdeklarimin që vërteton gjëndejn penale. Subjekti/organizatori, aksionarët dhe administratorët e tyre nuk duhet të jenë dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e krimit ekonomik, evazionit fiskal dhe/apo doganor, shpërdorim detyre, mitmarrje apo mitdhënie, vjedhje, trafik lëndësh narkotike apo armësh, eksplozivësh, mospagim gjobash apo për vepra të tjera penale që kompromentojnë personin në nderin e personalitetin e tij;
- gj) organizatori të ketë dokumentacionin teknik për të gjitha pajisjet elektronike dhe certifikatat përkatëse për këto pajisje në përputhje me standardet e BE-së. Miratimi i këtyre pajisjeve kryhet nga AMLF-ja sipas karakteristikave të Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line*;
- h) të bëjë pagesën për fondin e ngurtësimin për fituesit e lojërave të fatit menjëherë përpara paraqitjes së dokumentacionit administrativo-ligjor, sipas këtij ligji;
- i) të dorëzojë dokumentacionin që vërteton se ka në pronësi apo në përdorim të ligjshëm sipërfaqen në të cilën ushtron veprimtarinë;
 - j) të jetë i monitoruar *on-line* nga AMLF-ja duke i lidhur të gjitha makinat/aparaturat e miratuara në këtë sistem.
2. Përveç certifikatës së regjistrimit me NIUS-in, kriteret e sipërpërmendura vërtetohen nëpërmjet dokumenteve të lëshuara brenda 3 muajve të fundit nga data e miratimit/lëshimit të tyre nga organet përgjegjëse shtetërore, si dhe duhet të jenë origjinale apo kopje të noterizuara.

Neni 23

Rregullorja standarde e lojërave të fatit

Rregullorja e lojës së fatit propozohet nga organizatori dhe miratohet nga AMLF-ja.

Rregullorja detyruesisht duhet të përmbajë:

- a) emrin, selinë e organizuesit, oraret e funksionimit të sallave të basteve;
- b) emrin, përshkrimin dhe kohëzgjatjen e lojës së fatit;

- c) kushtet për pjesëmarrje në lojën e fatit;
- ç) kombinacionet;
- d) afatin e fundit për pjesëmarrje në lojë;
- dh) fondin e fitimit dhe llojin e fitimeve;
- e) përshkrimin e biletës;
- ë) mënyrën, procedurën dhe mbikëqyrjen e tërheqjes, përkatësisht mënyrën e verifikimit të fitimeve;
- f) mënyrën e publikimit të shumave të fondit fitues dhe rezultateve të lojës;
- g) mënyrën dhe afatin e pagesës së fitimeve monetare;
- gj) mënyrën e njohjes me rregullat të pjesëmarrësit në lojë;
- h) çdo dokumentacion të kërkuar nga AMLF-ja.

Neni 24

Kushtet fizike dhe teknike për pranimin e basteve

1. Organizatori, i cili pranon pagesën për bastet në pikat e basteve dhe ndërmjet terminaleve të vetëshërbimit, duhet të plotësojë kërkesat fizike dhe teknike të përcaktuara nga ky ligj, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Me udhëzim të ministrit të Financave përcaktohen standardet që kanë të bëjnë me kushtet teknike të sistemit të basteve nëpërmjet kanaleve të shitjeve interaktive *on-line*, duke përfshirë identifikimin dhe regjistrimin e lojtarëve, kërkesat e programeve *software* dhe *hardware*, certifikimin e sistemit, procedurat në lidhje me faturat dhe transaksionet e pagesave, parimet e sigurisë, kushtet e kontrollit, parimet e organizatës përgjegjëse etj. Një organizator i gatshëm për të organizuar baste do të harmonizojë dhe do të certifikojë sistemin e tij me standardet teknike të kërkuara.

Neni 25

Ndalime për zhvillimin e basteve

Ndalohet organizimi i basteve kur:

- a) është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe parimet e përgjithshme etike;
- b) organizatori është aksionar, anëtar i organeve drejtuese, përfaqësues ligjor apo është i lidhur në mënyrë direkte me një klub sportiv, i cili merr pjesë në evenimente sportive dhe brenda fushës për të cilën vendosen bastet sportive.

Neni 26

Organizimi i basteve në servera të certifikuar, të miratuar dhe të monitorueshëm nga AMLF-ja

Organizatori i basteve për të ushtruar aktivitetet duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

1. Organizatori i basteve sportive për komunikimin *on-line* ose jo duhet të instalojë pajisje bastesh me një siguri të lartë, të cilat duhet të jenë të gjitha të certifikuara nga subjekte të akredituara, të miratuara nga AMLF-ja dhe të monitoruara *on-line* nga AMLF-ja e të përputhen minimalisht me këto kërkesa:

- a) Zona qendrore, ku mbahen serverat e ku përpunohen koeficientët dhe informacionet e tjera, duhet të jetë e pajisur me një sistem kontrolli, që të regjistrojë çdo person që hyn dhe del në këtë zonë, datën, orën dhe identifikimin e personit dhe të ruajë regjistrimin për të paktën një periudhë 1- vjeçare;
- b) Zona duhet të ketë kamera të tipit CCTV, ku të gjitha pajisjet e lidhura të jenë të dukshme, në mënyrë të qartë;
- c) Zona duhet të jetë e ruajtur gjatë gjithë kohës;
- ç) Zona duhet të ketë një rrjet pajisjesh monitoruese që mund të kontrollohen nga AMLF-ja ose inspektorët e saj;
- d) Për bastet që zhvillohen *on-line*, i gjithë sistemi duhet të operojë mbi një server të dedikuar, të

autorizuar për administrimin e basteve, të certifikuar, të miratuar dhe të monitorueshëm *on-line* nga AMLF-ja nëpërmjet kredencialeve përkatëse të AMLF-së. Serveri në fjalë duhet të përmbushë të gjitha kushtet e nivelit të lartë të sigurisë, të sistemeve mbrojtëse, kundrejt ndërhyrjeve të rrezikshme nga elemente të rrezikshme për dëmtimin e të dhënave dhe daljen jashtë pune të këtyre serverave.

2. Organizatori duhet të paraqesë pranë AMLF-së për miratim informacionin e detajuar lidhur me sistemin e zhvillimit të basteve *on-line*, ku të përfshihen:

a) platforma skematike e komunikimit server-klient;
b) siguria e instaluar në këtë sistem;
c) të dhënat e plota teknike për serverat, pajisjet në platformat klient dhe të gjitha pajisjet e tjera që shërbejnë për *rout-in*, pajisjet për ruajtjen e informacionit (*back up*) dhe sigurinë e instaluar në këtë platformë.

3. Administratori i basteve sportive:

a) është i detyruar të ofrojë të drejta hyrëse për përfaqësuesit/inspektorët e AMLF-së në zonën, ku janë vendosur pajisjet e basteve dhe akses në servera për të bërë të mundur mbikëqyrjen e zhvillimit të aktivitetit të basteve në përputhje me ligjin;

b) duhet të marrë më parë miratimin paraprak nga AMLF për çdo ndryshim material të sistemit, përpara se ky ndryshim të fillojë të aplikohet nga organizatorët;

c) duhet të sigurojë që vetëm personat e autorizuar prej organizatorit do të kenë të drejta hyrëse në zonën, ku janë të vendosura pajisjet e basteve;

ç) duhet të garantojë që nuk do të ketë asnjë ndërhyrje në të dhënat e sistemit apo në pjesën e pajisjeve që është dedikuar për monitorimin *on-line*;

d) duhet të regjistrojë paraprakisht çdo lojtar që do të marrë pjesë në baste për shumën të luajtura ose të fituara, që kalojnë vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, si dhe të marrë e të ruajë të dhëna për identitetin e tyre;

dh) në rastin e basteve sportive *on-line* nuk duhet të pranojë nga lojtarët para *cash*, por pagesa duhet bërë vetëm nga llogaria bankare, me kartë krediti a debiti ose nga portofoli elektronik, i regjistruar nga klienti në një institucion financiar të njohur;

e) duhet t'i paguajë lojtarët fitues menjëherë, vetëm nga llogaria, ku janë depozituar pagesat dhe vetëm në llogarinë në emër të fituesit;

ë) nuk duhet të lejojë asnjë lojtar të mbajë më shumë se një llogari me organizatorin;

f) duhet të mbajë në një llogari bankare fondet e lojtarëve, të ndara nga fondet e tjera të pronësisë së organizatorit në një nga bankat e nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë;

g) duhet t'u ofrojë lojtarëve informacion të nevojshëm, të paktën nëpërmjet telefonit ose e-mail-it;

gj) duhet t'i paraqesë AMLF-së një raport mujor për shumën e luajtura nga lojtarët, si dhe fitimet e marra nga lojtarët fitues;

h) duhet të përmbushë dhe çdo kërkesë shtesë që mund të kërkohej nga AMLF-ja.

Neni 27

Kontrolli i basteve nga Sistemi Qendror i Monitorimit *On-line*

1. Organizatori i licencuar për organizimin e basteve do të sigurojë mundësinë për ruajtjen e biletave të basteve të vendosura nga lojtarët dhe pagesave nga fitimi, duke siguruar një sistem kontrolli të veprimeve të organizatorit. Organizatori i basteve do të bëjë të mundur që AMLF-ja të lidhet në sistemin e IT-së së tij, në kohë reale, me qëllim vërtetimin dhe sigurimin e kontrollit të pandërprerë dhe të drejtpërdrejtë, i konsideruar si "kontrolli i plotë".

2. Kontrolli i plotë përbën monitorim të besueshëm për regjistrimin dhe ruajtjen e informacionit mbi pagesat e pranuar nga bastet dhe pagesat e kryera nga organizatori për lojtarët fitues, si dhe siguron

informacion të saktë, real e të pandryshuar për pagesat e kryera.

KREU V ORGANIZIMI I LOTARISË KOMBËTARE

Neni 28

Lejimi i luajtjes së lojërave të Lotarisë Kombëtare

1. Licenca për të drejtën e organizimit të lojërave të Lotarisë Kombëtare jepet për një periudhë 10-vjeçare dhe miratohet me vendim të Këshilli të Ministrave, me propozimin e autoritetit të miratuar nga Këshilli i Ministrave për zhvillimin e garës për Lotarinë Kombëtare, në përputhje me këtë ligj. Kontrata e lidhur bëhet efektive pas miratimit nga Kuvendi. Kjo licencë është një e vetme dhe i jepet aplikantit, i cili përzgjidhet i pari në procesin e konkurrimit, të zhvilluar sipas procedurave të përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore, dalë në zbatim të tij.

2. Licenca e Lotarisë Kombëtare përfshin:

a) të gjitha lojërat numerike, ku numrat tërhiqen nga një radhë e paracaktuar numrash e në të cilat përcaktohen:

i) loja “Loto”, që është lojë fati, në të cilën organizatori pranon dhe zhvillon baste për shansin e fitimit të disa numrave nga një seri e paracaktuar numrash. Numrat fitues përcaktohen me hedhje publike të shortit të transmetuar drejtpërdrejt në një televizion kombëtar. Shuma e përgjithshme e çmimeve të fitueshme ndahet në disa kategori fitimi, ku, brenda secilës kategori, të gjitha fitimet janë të barabarta;

ii) “loja shtesë”, që është një lojë fati, e cila mund të zhvillohet vetëm në lidhje me lojërat e tjera, që lejohen të organizohen nga i licencuari. Numri fitues përcaktohet me hedhje publike të shortit. Fitojnë ata lojtarë, numri i biletës të të cilëve përputhet plotësisht ose pjesërisht me numrin fitues. Shuma e përgjithshme e çmimeve të fitueshme ndahet në disa kategori fitimi. Brenda secilës kategori të gjitha fitimet janë të barabarta;

b) loja “Keno”, që është një lojë fati, në të cilën organizatori pranon dhe zhvillon lojën lidhur me shanset e fitimit të kombinimeve të numrave, ku lojtarët fitojnë nëpërmjet përputhjes së kombinimeve përkatëse të numrave me numrat fitues të përcaktuar;

c) loja “Loto me shifra”, që është një lojë fati, në të cilën organizatori pranon dhe zhvillon lojën për shansin e fitimit të një ose më shumë numrave ose simboleve, nga një sasi të përcaktuar numrash a simbolesh. Numrat ose simbolet fituese përcaktohen me hedhje publike të shortit. Çmimi fitues individual është një shumëfish i paracaktuar i bastit të vënë në lojë ose shumën e çmimit ndahet në disa kategori fitimi. Të gjitha fitimet e secilës kategori janë të barabarta;

ç) lotaritë që mund të jenë:

i) “lotaritë e çastit”, që janë lojëra fati, në të cilat pjesëmarrësi i lojës mund të konstatojë menjëherë nëse ka fituar, duke kontrolluar a është printuar një çmim fitues në biletën e tij. Lojëra të tjera të çastit janë lojëra fati, në të cilat pjesëmarrësit e lojës mund të marrin dijëni për një fitim të mundshëm brenda 24 orëve pas mbarimit të bastit për shanset e fitimit të simboleve dhe kombinimeve të numrave;

ii) “lotaritë e numrave”, që janë lojëra fati, në të cilat çdo biletë e lotarisë ka një numër vijues të shënuar në të. Biletat fituese përcaktohen me hedhje publike të shortit;

iii) “lotaritë elektronike”, që janë lotari, në të cilat kontrata e lojës lidhet nëpërmjet mediave elektronike, vendimi mbi fitimin apo humbjen merret ose vihet në dispozicion në një mënyrë qendrore dhe pjesëmarrësi i lojës mund të marrë dijëni për rezultatin e këtij vendimi menjëherë pas pjesëmarrjes në lojë. Këtu nuk përfshihen makina elektronike dhe videolotari terminale.

2. Aplikanti, për marrjen e licencës për Lotarinë Kombëtare, duhet të paguajë menjëherë tarifën e licencimit në njërën nga bankat e vendit, për llogari të Ministrisë së Financave.

3. Organizatori i Lotarisë Kombëtare organizon të gjitha apo një pjesë të lojërave të Lotarisë

Kombëtare. Organizimi i lojërave bëhet nëpërmjet shitjes me pakicë të biletave, nëpërmjet rrjetit *on-line*, internetit apo përdorimit të shërbimit të telefonisë celulare. Organizatori i Lotarisë Kombëtare njofton AMLF-në për:

- a) të gjitha lojërat e ofruara, sapo të jetë marrë vendimi që ato të hidhen në treg nga organi i licencuar;
- b) çdo ndryshim të rëndësishëm të çdo loje, sapo të jetë marrë vendimi për ndryshimin nga organi i licencuar;
- c) adresat, në të cilat ushtron veprimtarinë për lojërat e Lotarisë Kombëtare, të cilat pajisen me NIUS sekondar në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 29

Procedura e hapjes së garës për Lotarinë Kombëtare

1. Autoriteti i autorizuar nga Këshilli i Ministrave shpall hapjen e garës për dhënien e licencës për Lotarinë Kombëtare, pas autorizimit të dhënë me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Këshilli i Ministrave miraton kriteret e vlerësimit të garës, dokumentet standarde, strukturën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
3. Autoriteti i autorizuar nga Këshilli i Ministrave për organizimin e garës publikon njoftimin për konkurrim në lojërat e fatit për Lotari Kombëtare, të paktën në një gazetë të huaj me qarkullim ndërkombëtar, në dy gazeta, që botohen në vendin tonë, në dy numra radhazi, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.
4. Njoftimi duhet të përmbajë:
 - a) vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumenteve;
 - b) gjuhën e paraqitjes së dokumenteve;
 - c) mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;
 - ç) vendin, orën dhe datën e shqyrtimit të doku-menteve.

Neni 30

Kriteret e licencimit për Lotarinë Kombëtare

1. Çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose të huaj, pas shpalljes së ftesës për ofertë nga autoriteti i autorizuar nga ligji, ka të drejtë të aplikojë pranë kësaj strukture për t’u pajisur me licencë për Lotari Kombëtare.
2. Kërkesa për licencën për Lotari Kombëtare shoqërohet me aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë, si dhe dokumentet e mëposhtme, që duhet të jenë origjinale apo të noterizuara dhe duhet të jenë lëshuar, brenda 3 muajve nga data e miratimit, nga organet përgjegjëse shtetërore:
 - a) dokumente, që vërtetojnë se aplikanti është i organizuar në formë shoqërie tregtare, tregtar apo bashkim shoqërisë;
 - b) dokumentin që vërteton se është shoqëri aksionare, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, në objektin e veprimtarisë të së cilës të pasqyrohet veprimtaria për lojëra fati, sipas llojit të lojës që kërkohet;
 - c) dokumentin që vërteton se kapitali i shoqërisë është jo më i vogël se 1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë) lekë;
 - ç) dokumentin nga institucionet përkatëse që personi apo personat juridikë nuk janë në proces falimentimi apo likuidimi;
 - d) një kopje të noterizuar të lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit;
 - dh) dokumentin, ku të shënohet se ka një përvojë në këtë veprimtari jo më pak se 3 vjet, të dhënë nga organi përkatës i vendit, ku aplikanti ka selinë qendrore;

e) deklaratën për burimin e kapitalit, që do të investohet për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e Lotarisë Kombëtare;

ë) vërtetimin nga organet tatimore për shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, si nga shoqëria që aplikon, ashtu edhe nga çdo subjekt juridik, në rast bashkimi shoqërisht;

f) vërtetimin se ka personel të kualifikuar në ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, të vërtetuara me dokumentacionin përkatës, i cili dorëzohet në çastin e aplikimit në ministrinë përgjegjëse për licencimin e Lotarisë Kombëtare;

g) rregulloren përkatëse për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të lojës, për të cilën kërkon të licencohet;

gj) planbiznesin për zhvillimin e veprimtarisë Lotari Kombëtare.

3. Kërkesa për licencë për Lotari Kombëtare përfshin, gjithashtu:

a) dokumente për të provuar ortakët/aksionarët e shoqërisë dhe pronarët e fundit përfitues të subjektit;

b) të dhëna për organet drejtuese të aplikantit dhe përfaqësuesit ligjorë;

c) të dhëna financiare për kryerjen e biznesit të ortakëve/aksionarëve të aplikantit për 3 vitet e fundit përpara paraqitjes së kërkesës;

ç) vërtetime për ortakët/aksionarët e shoqërisë dhe përfaqësuesit në organet drejtuese të saj e përfaqësuesit ligjorë se nuk janë në ndjekje penale;

d) dokumente ku të vërtetohet se subjekti aplikant është me status aktiv, e i padënuar penalisht, vërtetim që subjekti nuk është në procedura falimentimi, si dhe vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente, sipas juridiksionit territorial për subjektin:

i) se subjekti nuk është në ndjekje penale;

ii) se subjekti nuk është në gjykim për vepra penale;

iii) se subjekti nuk është i dënuar penalisht; dhe

iv) nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor, se subjekti nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera;

dh) dëshmi penalisht të dorëzuar nga aplikantët/administratorët dhe aksionarët/ortakët e shoqërisë në momentin e aplikimit, vërtetime që nuk janë në proces gjyqësor, që nuk janë dënuar penalisht me një vendim të formës së prerë për vepra penale në fushën e krimit ekonomik, evazionit fiskal dhe/apo doganor, shpërdorim detyre, mitmarrje apo mitdhënie, vjedhje, trafik lëndësh narkotike apo armësh, ekspozivësh, mospagim gjobash apo për vepra të tjera penale që kompromentojnë personat në nderin e personalitetin e tyre;

e) një marrëveshje paraprake, të paktën me njërën nga bankat e nivelit të dytë, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave;

ë) çdo informacion tjetër, që mund t'i kërkohe aplikantit nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe që gjykohe i nevojshëm për veprimtarinë që do të ushtrohet.

4. Kundërshtimi, refuzimi si dhe privilegjet e kërkuara nga aplikanti, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në shkronjën “d”, të pikës 3, të këtij neni, përbëjnë shkak ligjor për refuzimin e kërkesës nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Neni 31

Përzgjedhja e subjektit

1. Përzgjedhja e subjektit për lojërat e fatit Lotari Kombëtare bëhet nga autoriteti i autorizuar për organizimin e garës, në përputhje me kriteret e vlerësimit, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të vetëdeklarojnë, nën përgjegjësinë të tyre, se pjesëmarrja në këtë komision nuk përbën shkak për lindjen e një konflikti interesi me subjektet pjesëmarrëse në konkurrim. Për mosdeklarim zbatohen masat e parashikuara në ligjin nr.9367, datë

7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, brenda 15 ditëve nga përfundimi i procesit të përzgjedhjes, shpall listën e pjesëmarrësve në konkurrim, duke filluar renditjen nga aplikanti, që ka marrë numrin më të madh të pikëve. Kandidati, që ka marrë numrin më të madh të pikëve, shpallet fitues.

4. Kur aplikanti, i renditur i pari në listë, nuk vazhdon procedurat për marrjen e licencës, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së tij fitues, skualifikohet dhe shpallet fitues konkurrenti i renditur i dyti, sipas listës së miratuar. Në rast se edhe konkurrenti i dytë nuk vazhdon procedurën për marrjen e lejes, autoriteti i autorizuar nga ligji urdhëron përsëritjen e garës.

Neni 32

Njoftimi i fituesit për Lotarinë Kombëtare

1. Pas miratimit të listës së pjesëmarrësve në konkurrim, autoriteti i autorizuar nga ligji urdhëron publikimin e njoftimit të fituesit në faqen zyrtare të internetit të AMLF-së brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së njoftimit, aplikanti ka të drejtë të paraqesë çdo ankesë pranë autoritetit të autorizuar nga Këshilli i Ministrave për procedurën e zhvilluar.

2. Autoriteti i autorizuar, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankesës, përfundon shqyrtimin administrativ dhe njofton ankuesin për vendimin e marrë.

3. Me përfundimin e afatit për paraqitjen e ankesave dhe shqyrtimit të tyre, autoriteti i autorizuar nga ligji miraton dhënien e licencës për Lotari Kombëtare, pasi aplikanti i shpallur fitues të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) aplikanti, i shpallur i pari në listë, brenda 30 ditëve, duhet të bëjë pagesën për marrjen e licencës, në shumën e përcaktuar në këtë ligj;

b) të paraqesë fondin e garancisë, të lëshuar nga një bankë, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, në favor të Ministrisë së Financave, si garanci për fituesit e lojërave.

Neni 33

Miratimi i pajisjeve të Lotarisë Kombëtare

1. Asnjë pajisje nuk do të përdoret nga i licencuari për kategorinë “Lotari Kombëtare”, nëse ajo nuk është certifikuar nga subjekte të akredituara dhe nuk është miratuar si pajisje lotarie nga AMLF-ja. Këto pajisje duhet të shoqërohen me dokumentacionin teknik dhe certifikatat përkatëse në përputhje me standardet e BE-së.

2. Këshilli i Ministrave vendos minimumin e specifikimeve teknike që duhet të kenë pajisjet e lotarive, për t’u vlerësuar të ligjshme për përdorim në administrimin e lojërave.

3. I licencuari për lotari duhet të njoftojë AMLF-në për secilën dhe për çdo tip të pajisjeve që do të përdoren, për çdo lojë lotarie, duke siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm që AMLF-ja të verifikojë dhe të konfirmojë të gjitha specifikimet teknike e standardet e çdo pajisjeje të lotarive.

4. Një pajisje lotarie vlerësohet e miratuar, nëse përmbush specifikimet teknike, të vendosura nga Këshilli i Ministrave.

5. Nëse një tip i veçantë pajisjeje është i certifikuar/i miratuar, atëherë të gjitha pajisjet e këtij lloji duhet të miratohen.

6. Sistemi qendror i Lotarisë Kombëtare dhe pajisjet që do të përdoren nga i licencuari duhet të lidhen me Sistemin Qendror të Monitorimit *On-line* nga AMLF-ja. Miratimi i këtyre pajisjeve kryhet nga AMLF-ja sipas karakteristikave të Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line*.

KREU VI

ORGANIZIMI I KAZINOSË DHE RESORT KAZINO

Neni 34

Lejimi i ushtrimit të aktivitetit në kazino

1. Në secilën zonë të përcaktuar si me rëndësi kombëtare lejohen të jepen një licencë për kategorinë “Kazino” dhe një licencë për kategorinë “Resort kazino”.

2. Zonat me rëndësi kombëtare, ku do të vendosen kategoritë “Kazino” dhe “Resort kazino”, do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen procedurat e zhvillimit të garës, procedurat e licencimit, kushtet, kriteret dhe vendndodhja e kategorisë “Resort kazino”, kriteret shtesë për aplikantët që konkurrojnë për t’u pajisur me licencë për “Resort kazino”, procedura e shpalljes së fituesit, si dhe rastet e revokimit apo të pezullimit të kësaj licence.

4. Kontrata e lidhur me fituesin e garës, si dhe çdo çështje tjetër që ka të bëjë me aktivitetin e “Resort kazino” do përcaktohet me ligj të veçantë.

5. AMLF-ja është autoriteti përgjegjës për organizimin e garës për subjektet që dëshirojnë të konkurrojnë për të fituar të drejtën e organizimit të lojës së fatit të kategorisë “Kazino”, në secilën prej zonave në të cilat lejohet ky lloj organizimi.

6. Licenca miratohet nga drejtori i Përgjithshëm i AMLF-së dhe i jepet aplikantit, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij dhe shpallet fitues në garë.

Neni 35

Kufizime për zhvillimin e aktivitetit të lojërave të fatit për kategoritë “Kazino” dhe “Resort kazino”

1. Lojërat e fatit “Kazino” dhe “Resort kazino” lejohen të organizohen vetëm në zonat me rëndësi kombëtare duke respektuar distancat nga territori administrativ i njësisë vendore, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Përveç parashikimeve të pikës 1, të këtij neni, lejohet zhvillimi i aktivitetit të lojërave të fatit për kategorinë “Kazino” në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë me kusht që të jenë të vendosura në hotelet e certifikuar me 5 vje nga institucionet përgjegjëse dhe që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj. Një hotel i klasifikuar sipas institucioneve përgjegjëse klasifikohet automatikisht si subjekt që mund të marrë licencë kazinoje.

3. Organizatori aplikon pranë AMLF-së për konkurrim për të fituar të drejtën për të ushtruar aktivitet “Kazino” në zonat e miratuara sipas neneve 36 dhe 37 vijues, të këtij ligji.

Neni 36

Procedurat për licencimin e kazinove dhe lojërave elektronike në distancë

1. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen procedurat e zhvillimit të garës, kriteret shtesë për aplikantët që konkurrojnë për t’u pajisur me licencë për kategorinë “Kazino” e procedura e shpalljes së fituesit, si dhe rastet e revokimit apo të pezullimit të kësaj licence.

2. AMLF-ja shpall hapjen e garës për dhënien e licencës për “Kazino” dhe ka detyrimin të publikojë njoftimin për konkurrim në lojërat e fatit për kategorinë “Kazino”, në faqen e saj zyrtare të internetit, në dy gazeta, që botohen në vendin tonë, në dy numra radhazi, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike.

3. Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumenteve;
- b) gjuhën e paraqitjes së dokumenteve;
- c) mënyrën e paraqitjes së dokumenteve;
- ç) vendin, orën dhe datën e shqyrtimit të dokumenteve.

4. Çdo person juridik apo bashkim personash juridikë, vendas ose të huaj, që kërkojnë të

konkurrojnë për t'u pajisur me licencë për kategorinë "Kazino" në zonën për të cilin është shpallur gara, aplikojnë pranë AMLF-së.

5. Në fazën e pranimit të aplikimeve subjekti aplikues duhet të përmbushë kriteret minimale, si më poshtë vijon:

- a) të jetë shoqëri aksionare, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, në objektin e veprimtarisë të së cilës të pasqyrohet veprimtaria për lojëra fati, sipas llojit të lojës që kërkohet;
- b) shuma e kapitalit duhet të jetë jo më pak se 1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë) lekë;
- c) të deklarohet burimi i kapitalit, që do të investohet për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e "Kazinosë";
- ç) të kenë përvojë në fushën e lojërave të fatit;
- d) të ketë kapacitetet e duhura financiare, administruese, organizative dhe besueshmëri e aplikantit për t'u angazhuar me sukses në projekte të tilla;
- dh) të paraqesë garancinë pasurore, së bashku me aplikimin dhe me kushtet e sekuestrimit të kësaj garancie;
- e) të paraqesë kufizimet për ndryshimet e pronësisë së aksioneve për të licencuarit;
- ë) të ngrejë serverin, në të cilin do të japë informacion të plotë mbi çdo transaksion që do të kryehet midis subjektit dhe lojtarëve, xhiron dhe fitimin, si dhe çdo të dhënë që do të kërkohet nga AMLF-ja në lidhje me zhvillimin e këtij aktiviteti. AMLF-ja do të ketë akses në kohë reale te ky server.

6. Kërkesa për t'u pajisur me licencë për kategorinë "Kazino" duhet të shoqërohet dhe me dokumentacionin si më poshtë:

- a) dokumente shkresore për të provuar të dhëna për aksionarët e shoqërisë dhe pronarët përfitues;
- b) të dhëna për organet drejtuese të aplikantit dhe përfaqësuesin ligjor;
- c) të dhëna financiare për kryerjen e biznesit të aksionarëve të aplikantit, për 3 vitet e fundit, përpara paraqitjes së kërkesës;
- ç) dokumente për aksionarët e shoqërisë dhe të përfaqësuesit të saj, informacion për organet drejtuese, dokumente ku të vërtetohet se subjekti aplikant është me status aktiv dhe i padënuar penalisht, vërtetim që subjekti nuk është në procedura falimentimi, si dhe vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit territorial për subjektin:
 - i) se subjekti nuk është në ndjekje penale;
 - ii) se subjekti nuk është në gjykim për vepra penale;
 - iii) se subjekti nuk është i dënuar penalisht; dhe
 - iv) nga Zyra e Përmbartimit Gjyqësor, se subjekti nuk është në proce ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera;
- d) dëshmi penalisht të dorëzuar nga aplikantët /administratorët dhe ortakët e shoqërisë në momentin e aplikimit, vërtetime që nuk janë në proces gjyqësor, që nuk janë dënuar penalisht me një vendim të formës së prerë për vepra penale në fushën e krimit ekonomik, evazionit fiskal dhe/apo doganor, shpërdorim detyre, mitmarrje apo mitdhënie, vjedhje, trafik lëndësh narkotike apo armësh, eksplozivësh, mospagim gjobash apo për vepra të tjera penale që kompromentojnë personat në nderin e personalitetin e tyre.
- dh) një marrëveshje paraprake, të paktën me njërën nga bankat e nivelit të dytë, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, për arkëtimin, depozitimin dhe transferimin e pagesave;
- e) fondin e lojtarit dhe fondin e garancisë të depozituar në favor të AMLF-së për shlyerjen e detyrimeve karshi këtij të fundit në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 47, të këtij ligji;
- ë) çdo informacion tjetër, të cilin autoriteti i autorizuar e gjykon të nevojshëm t'ia kërkojë aplikantit për fushën e veprimtarisë që do të ushtrohet.

7. Kundërshtimi, refuzimi apo dhe devijimet e bëra nga aplikanti, në kundërshtim me përcaktimet e parashikuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, përbëjnë shkak ligjor për

refuzimin e kërkesës për licencim.

8. Në rast të paraqitjes të disa aplikimeve nga subjekte që përmbushin kriteret për licencim, do të shpallet fituese shoqëria që ka paraqitur ofertën financiare më të lartë.

9. Parashikimet e pikave 5 e 6, të këtij neni, janë kritere për licencim për kategorinë “Lojëra elektronike në distancë”. Kushtet dhe kërkesat teknike që duhet të plotësojë subjekti që do të licencohet për kategorinë “Lojëra elektronike në distancë” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 37

Njoftimi i pranimit ose refuzimit të aplikimit

1. AMLF-ja njofton me shkrim aplikuesit për pranimin ose refuzimin e aplikimit, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

2. Në rast refuzimi, aplikuesi ka të drejtë, brenda 30 ditëve nga data që ka marrë njoftim apo nga data kur ka marrë dijeni për njoftimin e refuzimit, të bëjë ankesë te ministri i Financave, i cili duhet të kthejë përgjigje brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit.

3. Vendimi i ministrit është përfundimtar nga ana administrative.

4. Në rast të pranimit të aplikimit, AMLF-ja kërkon nga aplikuesi të paguajë tarifën e përcaktuar në nenin 19, të këtij ligji, si dhe fondin e ngurtësimit e fondin garancisë të lëshuar nga një bankë, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, në favor të Ministrisë së Financave, në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga kjo e fundit, si garanci për fituesit e lojërave të fatit. Pagesa e tarifës dhe ajo e fondit të garancisë së fituesit bëhen brenda afatit të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.

5. Në rast se aplikimi i pranuar është bërë nga një person juridik i huaj, ky i fundit duhet që, së bashku me pagesat e parashikuara në pikën 4, të këtij neni, të paraqesë dhe dokumentacionin, i cili vërteton krijimin e një shoqërie si person juridik shqiptar.

6. Pas fazës së shqyrtimit të dokumentacionit të lidhur me pranimin e aplikimeve hapet faza konkurruese, e cila zhvillohet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave të parashikuar në pikën 2, të nenit 36, të këtij ligji.

Neni 38

Rregullorja e lojërave të fatit për kazino

1. Organizatori përgatit për secilën lojë, që do të luhet në kazino, rregulloren, të cilën ua bën të njohur pjesëmarrësve në lojëra.

2. Rregulloret e lojërave përfshijnë, kryesisht:

a) rregullat për mënyrën e pjesëmarrjes në lojë dhe përcaktimin e maksimumit dhe të minimumit të shumës, që paguhet për çdo lojë;

b) kushtet për lejimin e hyrjes së personave në kazino;

c) orën e hapjes dhe të mbylljes së kazinosë.

3. Miratimi i rregullores së paraqitur nga i licencuari bëhet nga AMLF-ja, në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregulloren e miratuar për këtë qëllim.

Neni 39

Identifikimi i klientëve të kazinosë dhe verifikimi i identifikimit të tyre

1. Hyrja në kazino dhe pjesëmarrja në lojë do të lejohen vetëm për personat mbi 21 vjeç, të cilët janë të detyruar të identifikohen me dokument identifikimi.

2. Të dhënat identifikuese të lojtarëve, të regjistruara sipas pikës 3, të nenit 6, të ruhen nga operatori për të paktën 3 vjet. Ruajtja e tyre të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Të dhënat, sipas pikës 2, të këtij neni, janë konfidenciale dhe operatori nuk mund t’ua bëjë

publike palëve të treta, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.

4. Organizatori duhet të ofrojë siguri fizike për lojtarët dhe klientët në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

5. Personi i veshur me uniformë, me funksione publike, mund të hyjë në një kazino vetëm për arsye profesionale të ushtrimit të detyrës dhe për asnjë arsye tjetër.

Neni 40

Detyrimet e të licencuarit për kazino

Licenca për zhvillimin e lojërave në kazino bëhet efektive, kur, përveç kushteve të parashikuara në dispozitat e neneve të tjera të këtij ligji, plotësohen edhe kushtet e mëposhtme:

a) lojërat zhvillohen në salla të caktuara, paraprakisht për këtë qëllim, duke respektuar detyrimet për vendndodhjen sipas parashikimeve të specifikuara në këtë ligj;

b) përdoren pajisje të standardeve të kërkuara sipas karakteristikave teknike të përcaktuara në nenet 42 dhe 43 vijues;

c) lojërat monitorohen *on-line* nga AMLF-ja;

ç) miratimi i këtyre pajisjeve kryhet nga AMLF-ja sipas karakteristikave të Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line*;

d) punësohet personel i përshtatshëm, që zotëron njohuri profesionale në këtë fushë. Personeli i punësuar në kazino duhet të jetë, të paktën, mbi moshën 21 vjeç, të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar, si dhe nuk duhet të jetë i dënuar më parë penalisht për vepra penale, të cilat parashikojnë dënim me burgim;

dh) duhet të ketë miratim të Ministrisë së Brendshme për masat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, brenda dhe jashtë sallës ku do të zhvillohen lojërat.

Neni 41

Ndalimet për kazinonë

1. Nëse lojërat e fatit, që zhvillohen në kazino, bien në kundërshtim ose cenojnë interesin e përgjithshëm publik, AMLF-ja revokon licencën për zhvillimin e tyre ose ndërpret pa paralajmërim procedurat për dhënien e licencës për organizatorin, që është në proces aplikimi.

2. Rastet kur cenohet interesi i përgjithshëm publik, në kuptim të pikës 1, të këtij neni, dhe kur duhet të zbatohen këto masa, janë:

a) mashtrimi i publikut;

b) pastrimi i parave dhe/ose financimi i terro-rizmit;

c) cenimi i rendit publik dhe nxitja e krimina-litetit.

Neni 42

Specifikimet teknike të makinave elektronike

1. Çdo makinë elektronike duhet:

a) të jetë në përputhje me rregullat/direktivat e zbatueshme të sigurisë së BE-së. (*EC Safety regulations*);

b) të jetë e pajisur me deklaratën e përputhshmërisë nga prodhuesi për plotësimin e standardeve nga BE (standardet CE);

c) të jetë e pajisur me:

i) certifikatën e prodhimit;

ii) certifikatën e origjinës;

iii) dokumentet e zhdoganimit;

ç) të jetë e pajisur me certifikatën CE dhe EMC bashkë me raportin e testimit, të lëshuar nga një institut i akredituar për testimin e këtyre standardeve.

d) të ketë një gjenerues rastësor numrash (*Random Number Generator-RNG*), të instaluar në të,

i cili duhet të plotësojë kërkesat e kësaj dispozite;

dh) të ketë memorie fiskale për transferimin e të dhënave të xhiros *on-line* te SQMO.

e) të mund të lidhet me Sistemin Qendror të Monitorimit On-line nga AMLF-ja. Miratimi i këtyre pajisjeve kryhet nga AMLF-ja, sipas karakteristikave të Sistemit Qendror të Monitorimit On-line;

ë) makina elektronike e certifikuar nga institutet e akredituara duhet të miratohet nga AMLF-ja në përputhje me nenin 42, të këtij ligji.

2. Çdo lojë e një makine elektronike duhet të ketë:

a) përshkrimin e duhur, i cili duhet të përfshijë:

i) titullin e lojës;

ii) numrin serial;

iii) rregullat e luajtjes së saj;

b) rezultate të rastësishme, të përcaktuara nga një gjenerator numrash të rastësishëm, të vendosur në makinën elektronike.

3. Gjeneruesi rastësor i numrave (RNG), i instaluar në të, duhet të jetë i miratuar nga një laborator testues, ndërkombëtar ose kombëtar, (pjesë e piramidës/hierarkisë së sistemit të cilësisë), i akredituar për programet *software* të lojërave. Ky laborator duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO EN 17025 ose ISO EN 17020 dhe duhet të ketë lëshuar një certifikatë miratimi, e cila duhet të përmbajë përshkrimin e RNG-së dhe të funksionimit të tij, përfshirë rastësinë dhe normativën e pagesës.

4. Makinë elektronike do të lejohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm nga subjektet e licencuara nga AMLF-ja për kategorinë “Kazino” dhe “Resort kazino”.

Neni 43

Miratimi i videolotari-terminaleve (VLT)

1. Asnjë shoqëri nuk mund të vendosë apo të ofrojë lojëra sipas konceptit/funksionimit të VLT-së, deri në çastin që VLT-ja të të miratohet nga AMLF-ja (nëse kjo VLT përmbush specifikimet teknike të tipit të saj). VLT do të lejohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm nga subjektet e licencuara nga AMLF-ja për kategorinë “Kazino” dhe “Resort kazino”.

2. Çdo VLT duhet:

a) të jetë e shoqëruar me certifikatën e plotë dhe korrente dhe me deklaratën e konformitetit;

b) të ketë certifikatën e prodhimit, certifikatën e origjinës dhe dokumentet e zhdoganimit;

c) të jetë pajisur me pullën e sigurisë nga AMLF-ja;

ç) të ketë memorie fiskale për transferimin e të dhënave të xhiros *on-line* te SQMO.

d) të jetë në përputhje me rregullat e direktivat e BE-së, të zbatueshme për sigurinë (*EC Safety regulations*);

dh) të jetë e pajisur me deklaratën e përputhshmërisë nga prodhuesi për plotësimin e standardeve të përcaktuara nga BE-ja (standardet CE);

e) të jetë e pajisur me certifikatën CE dhe EMC bashkë me raportin e testimit, të lëshuar nga një institut për testimin e këtyre standardeve;

ë) të përmbajë lojëra, në përputhje me kërkesat e pikës 3, të këtij neni;

f) të jetë e pajisur me pullën e sigurisë nga AMLF-ja me vulën përkatëse.

3. Çdo lojë në një VLT duhet të ketë:

a) përshkrimin e duhur, ku përfshihen:

i) titulli i lojës;

ii) numri serial;

- iii) rregullat e luajtjes së saj;
 - b) rezultate të rastësishme, të përcaktuara nga një gjenerator numrash të rastësishëm, të vendosur në serverin qendror, tek i cili VLT-ja në fjalë së bashku me VLT-të e tjera të përdorura për video-lotari janë të lidhura (*connected*);
 - c) të paktën normativën e pagesës 80 për qind (të përcaktuar mbi një cikël minimal prej 200 000 lojërash, të luajtura ose të simuluar, për t'u luajtur).
4. Një gjenerator numrash të rastësishëm (RNG) në serverin qendror, kur VLT-të e përdorura në video-lotaritë janë të lidhura, duhet:
- a) të jetë i miratuar nga një laborator testues ndërkombëtar ose kombëtar (pjesë e piramidës së sistemit të cilësisë), i akredituar për programet *software* të lojërave, në bashkëpunim me AMLF-në. Ky laborator duhet të jetë i certifikuar, në bazë të standardeve ndërkombëtare ISO EN 17025 ose ISO EN 17020;
 - b) të ketë një certifikatë miratimi, dhënë nga laboratori i sipërpërmendur, e cila duhet të përmbajë përshkrimin e RNG-së dhe funksionimin e tij, përfshirë rastësinë dhe normativën e pagesës.
5. Çdo VLT, e certifikuar nga institucionet përkatëse të akredituara dhe e miratuar nga AMLF-ja, duhet të ketë gjatë të gjithë kohës, të afishuar (të ngjitur) në një vend të dukshëm “Pullën e rregullsisë”, të vlefshme, e cila duhet:
- a) të përmbajë elementet e sigurisë së këtyre pajisjeve, përfshirë:
 - i) numrin unik serial;
 - ii) hologramën;
 - iii) emrin ose kodin e certifikatës/licencës për operimin e makinave të lojërave të fatit;
 - iv) formën dhe ngjyrën e saj orgjinale, e cila mund të ndryshojë çdo 3 muaj apo pas çdo kohe, të vendosur nga AMLF-ja.
 - b) të sigurohet dhe të fiksohet në çdo pajisje të lojërave të fatit, të miratuar, nga AMLF-ja;
 - c) të jetë e vlefshme për një periudhë 3-mujore ose për aq kohë sa vendoset nga AMLF-ja.

KREU VII ORGANIZIMI I BINGOS TELEVIZIVE

Neni 44

Lejimi i bingos televizive dhe pagesat

Personi juridik mund të ushtrojë aktivitetin e lojërave të fatit “Bingo televizive” kur është licensuar sipas kriterëve të parashikuara në nenin 45 dhe kryen pagesat në përputhje me nenet 14 dhe 19 të këtij ligji.

Neni 45

Kriteret e lejimit për organizimin e bingos televizive

1. Kriteret që duhet të plotësojë një organizator për marrjen e miratimit nga AMLF-ja për organizimin dhe ushtrimin e lojërave të fatit “Bingo televizive” janë, si më poshtë vijon:
 - a) të jetë shoqëri aksionare, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, në objektin e veprimtarisë të së cilës të pasqyrohet veprimtaria për lojëra fati, sipas llojit të lojës që kërkohet;
 - b) të paraqesë certifikatën e regjistrimit me numrin unik të identifikimit të subjektit NIUS-in e shoqërisë;
 - c) shoqëria të ketë kapital themeltar jo më të vogël se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë për kategorinë “Bingo televizive”;

ç) të depozitojë dokumentacion të plotë në lidhje me aksionarët e shoqërisë, nga i cili të dalë qartë struktura e pronësisë së subjektit, informacioni për kapitalet dhe interesat e aksionarëve në shoqëri të tjera, si dhe të identifikohet deri në fund individ/individët përfitues;

d) të paraqesë rregulloren e lojës, sipas nenit 23, të këtij ligji;

dh) të ketë një marrëveshje paraprake, për të bashkëpunuar me njërin nga bankat e nivelit të dytë me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë për arkëtimin, depozitim dhe transferimin e pagesave;

e) të paraqesë ekstraktin nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, ku të vërtetohet se shoqëria është me status aktiv, nuk është në procedura likuidimi dhe vërtetim që subjekti nuk është në procedura falimentimi, nuk është dënuar me një vendim penal të formës së prerë, si dhe vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit territorial për subjektin:

i) se subjekti nuk është në ndjekje penale dhe është i padënuar penalisht;

ii) se subjekti nuk është në gjykim për vepra penale;

iii) nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor se subjekti nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

ë) të ketë genplanin, sipas të cilit vërtetohet distanca nga institucionet shtetërore sipas pikës 2, të nenit 7, të këtij ligji.

f) të ketë depozituar fondin e garancisë në favor të AMLF-së për shlyerjen e detyrimeve karshi këtij të fundit në përputhje me pikën 2, të nenit 47, të këtij ligji;

g) aplikantët/administratorët dhe aksionarët e shoqërisë të dorëzojnë në momentin e aplikimit dëshmi penaliteti, vërtetime nga gjykata që nuk janë në proces gjyqësor dhe nga prokuroria që nuk janë në procedim penal, si dhe vetëdeklarimin që vërteton gjendjen penale. Subjekti/organizatori, aksionarët dhe administratorët e tyre nuk duhet të jenë dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e krimit ekonomik, evazionit fiskal dhe/apo doganor, shpërdorim detyre, mitmarrje apo mitdhënie, vjedhje, trafik lëndësh narkotike apo armësh, eksplozivësh, mospagim gjobash apo për vepra të tjera penale që komprometojnë personin në nderin e personalitetin e tij;

gj) të ketë teknologjinë e nevojshme për luajtjen dhe funksionimin e mjeteve të lojërave të fatit të certifikuara nga institute të akredituara e të miratuara nga AMLF-ja, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj;

h) të krijojë fondin e ngurtësimit për fituesin e lojës, përpara paraqitjes së dokumentacionit administrativo-ligjor, të kërkuar nga ky ligj;

i) çdo informacion tjetër, që mund t'i kërkohej aplikantit nga AMLF-ja dhe që gjykohej i nevojshëm për fushën e veprimtarisë që do të ushtrohet.

j) të ketë marrëveshje ndërmjet organizatorit të lojës dhe agjentëve për shitjen e biletave;

k) të ketë marrëveshje ndërmjet organizatorit të lojës dhe operatorit apo operatorëve të telefonisë celulare;

l) të ketë marrëveshje për transmetimin e lojës (shorteut) për kategorinë “Bingo televizive”, e lidhur ndërmjet organizatorit dhe një stacioni televiziv kombëtar;

ll) të ketë strategji për informimin e klientëve për rregullat e kësaj loje, ku duhet të përcaktohen data e hedhjes së shortit, mënyra e luajtjes, vendi ku do të tërhiqen çmimet, të dhënat për vendin ku do të bëhet transmetimi dhe nxjerrja e rezultateve;

m) më ketë rregullore të lojës dhe fondin për fituesin, i cili, për çdo lojë, nuk mund të jetë më i vogël se 80 për qind e shumës nga vlera e arkëtuar nga shitja e biletave dhe nga prenotimi nëpërmjet telefonisë celulare.

2. Përveç NIUS-it, kriteret e sipërpërmendura vërtetohen nëpërmjet dokumenteve të lëshuara, brenda 3 muajve nga data e miratimit të tyre, nga organet përgjegjëse shtetërore, si dhe duhet të jenë origjinale apo të noterizuara.

3. Organizatori i bingos televizive organizon lojën nëpërmjet shitjes me pakicë të biletave, nëpërmjet rrjetit *on-line*, internetit apo përdorimit të shërbimit të telefonisë celulare. Organizatori i bingos

televizive njofton AMLF-në për adresat, në të cilat ushtron veprimtarinë, të cilat pajisen me NUIS sekondar në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

KREU VIII AUTORIZIME TË TJERA TË AMLF-SË

Neni 46

Autorizime nga AMLF-ja

1. Importimi dhe tregtimi i pajisjeve të lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë lejohen vetëm nga personat juridikë të pajisur me autorizim nga AMLF-ja.

2. Organizatorët, që ushtrojnë aktivitetin e lojërave të fatit të basteve sportive, do të përdorin vetëm programe *software*, të ndërtuara nga subjekte të autorizuar nga AMLF-ja për këtë qëllim, sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave. Programimi i lojërave të fatit “Baste sportive” në Republikën e Shqipërisë lejohet vetëm për personat juridikë të pajisur me autorizim të AMLF-së.

KREU IX GARANCITË

Neni 47

Fondi i garancisë

1. Për krijimin e garancive për fituesit e lojërave të fatit, organizatori është i detyruar të ngurtësojë një fond prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, në një llogari të veçantë bankare, në favor të Ministrisë së Financave, i cili zhbllkohet vetëm me urdhër të ministrit të Financave.

2. Për krijimin e garancive për shlyerjen e detyrimeve periodike karshi AMLF-së, organit tatimor etj, organizatori është i detyruar të ngurtësojë një fond prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, në një llogari të veçantë bankare, në favor të AMLF-së, i cili zhbllkohet vetëm me urdhër të ministrit të Financave.

3. Mosngurtësimi i fondeve të garancisë përbën shkak ligjor për pezullimin dhe heqjen e licencës nga AMLF-ja.

4. AMLF-ja i propozon ministrit të Financave zhbllkimin e këtij fondi në këto raste:

a) me kërkesë të organizatorit të lojërave, në rast se ky i fundit mbyll veprimtarinë e tij në fushën e lojërave të fatit, pasi ka vërtetuar se nuk ka detyrime tatimore apo detyrime karshi AMLF-së, e vërtetuar kjo nga organet shtetërore përkatëse.

b) në rast falimentimi apo heqjeje të licencës së ushtrimit të veprimtarisë.

5. Në rast falimentimi, heqjeje të lejes së ushtrimit të veprimtarisë apo mosshlyerjes së detyrimeve periodike karshi AMLF-së veprohet, si më poshtë:

a) fondi i garancisë për lojtarin përdoret për shlyerjen e detyrimeve për pagesën e fitimeve të lojtarëve;

b) fondi i garancisë për AMLF-në përdoret sipas kësaj radhe:

i) për pagesën e detyrimeve që ka ndaj AMLF-së;

ii) për pagesën e detyrimeve ndaj organeve tatimore dhe organeve të tjera ku organizatori rezulton debitor.

KREU X
SISTEMI QENDROR I MONITORIMIT *ON-LINE*

Neni 48

Monitorimi *on-line*

1. Sistemi Qendror i Monitorimit *On-line* (SQMO) i lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë shfrytëzohet nga AMLF-ja, e cila merr të dhënat nga sistemi në kohë reale.

2. Këshilli i Ministrave përcakton mënyrën dhe kriteret e përzgjedhjes së operatorit që do të ndërtojë SQMO, autoritetin përgjegjës që do të kryejë procedurat e përzgjedhjes, si dhe tarifën e mirëmbajtjes së Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line* që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara.

Neni 49

Përditësimi, modifikimi dhe përshtatja e SQMO-së

1. AMLF-ja do t'i kërkojë çdo organizatori të licencuar sipas ligjit të lidhë pajisjet përkatëse të lojërave të fatit dhe/ose sistemet qendrore të përdorura prej tyre në një sistem qendror të monitorimit të operuar nga AMLF-ja dhe për të mbajtur një lidhje të tillë aktive *on-line* gjatë të gjithë periudhës së ushtrimit të aktivitetit.

2. AMLF-ja do t'i kërkojë çdo organizatori, sipas rastit, të përmirësojë, të modifikojë, të përshtatë ose të zëvendësojë pajisjet përkatëse të lojërave të fatit dhe/ose pajisjet që lidhen me to për të siguruar përputhshmërinë e tyre me Sistemin Qendror të Monitorimit *On-line*, të operuar nga AMLF-ja në përputhje me specifikimet teknike që mund të caktohen nga AMLF-ja, në çdo kohë.

Neni 50

Funksioni i AMLF-së nëpërmjet Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line*

1. AMLF-ja përdor një sistem qendror për monitorimin dhe marrjen e informacionit në lidhje me lojërat e fatit, i cili konsiston, por nuk kufizohet në:

a) shumat e përdorura për të luajtur një lojë nëpërmjet një pajisjeje përkatëse lojërash dhe destinacionin e shumave të luajtura;

b) të ardhurat bruto nga loja, të gjeneruara nga secila pajisje përkatëse e lojërave;

c) numrin dhe vendndodhjen e pajisjeve përkatëse të lojërave të lidhura me sistemin qendror të monitorimit;

ç) defektet me pajisjet përkatëse të lojërave;

d) ndërhyrjet në pajisjet përkatëse të lojërave;

dh) kundërvajtjet e dyshuara në lidhje me këtë ligj apo aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;

e) kontrollin e pajisjeve përkatëse të lojërave, direkt ose nëpërmjet një sistemi qendror me të cilin mund të jenë lidhur pajisjet përkatëse të lojërave;

ë) aktivizimin ose çaktivizimin e pajisjeve përkatëse të lojërave, direkt ose nëpërmjet një sistemi me të cilin mund të jenë lidhur pajisjet përkatëse të lojërave.

2. Funksionet e tjera të Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line* do të specifikohen me

udhëzim të ministrit të Financave.

3. Në qoftë se një defekt në Sistemin Qendror të Monitorimit *On-line* ose në sistemin e telekomunikacionit të përdorur për të operuar sistemin qendror të monitorimit i shkakton pajisjeve përkatëse të lojërave të fatit ose sistemeve qendrore mosfunksionimin, AMLF-ja nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë kompensim të asnjë personi për humbje ose dëm të shkaktuar nga dështimi i funksionimit të pajisjeve përkatëse të lojërave dhe/apo sistemeve qendrore.

Neni 51

Përgjegjësia e organizatorit për monitorimin *on-line*

1. Çdo organizator, përfaqësues ligjor, punonjës i tij apo çdo person tjetër, i cili shkel ndonjë nga dispozitat e këtij kreu, në lidhje me çdo kundërshtim, mosrespektim të dispozitave të këtij kreu dhe/ose bllokimin, heqjen, shkatërrimin ose çaktivizimin e pajisjeve përkatëse të lojërave, sistemit qendror, pajisje në lidhje me to ose çdo pajisje ose *software* të lidhura me to, do të jetë përgjegjës për këtë veprim dhe AMLF-ja do të procedojë me masa administrative, sipas parashikimeve të nenit 53, të këtij ligji.

2. Organizatori ka detyrimin ta ruajë, ta mirëmbajë dhe të mos lejojë ndërhyrje në sistemin që lidhet me monitorimin *on-line* nga AMLF-ja dhe është përgjegjëse për çdo ndërhyrje në sistemin qendror të monitorimit.

KREU XI

DETYRIMET TATIMORE

Neni 52

Detyrimet tatimore

1. Veprimtaritë e lojërave të fatit përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

2. Të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit taten në masën 15 për qind, përveç rasteve të parashikuara ndryshe me ligj të veçantë.

3. Organizatorët e kategorisë “Baste sportive” taten në masën e parashikuar në përputhje me pikën 2, të këtij neni, por jo më pak se 40 000 (dyzet mijë) lekë në muaj, për çdo pikë sekondare të hapur. Krahas detyrimit tatimor të përmendur në pikën 2, të këtij neni, organizatorët e kategorisë “Baste sportive” dhe “Baste për gara në pistë”, brenda 31 marsit të vitit pasardhës, derdhen në llogari të ministrisë përgjegjëse për sportin shumë prej 0,4 për qind të xhiros vjetore. Ministria përgjegjëse për sportin duhet të njoftojë AMLF-në në rast se organizatori nuk derdhet në llogari shumë e cilësuar në këtë pikë. Organizatori duhet të depozitojë kopje të mandatpagesës edhe pranë AMLF-së.

4. Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojërave të fatit në “Kazino”, “Kazino në hotele me 5 yje” dhe “Resort kazino” paguajnë detyrimet tatimore mujore, për:

a) tryezat me më shumë se një pozicion (ruletë), një taksë mujore në masën 12 për qind mbi vëllimin e qarkullimit të realizuar në bazë të arkëtimeve, por jo më pak se 300 000 (treqind mijë) lekë në muaj për çdo pozicion;

b) çdo tryezë të lojërave (me letra dhe/ose me zara), një taksë mujore në masën 12 për qind mbi vëllimin e qarkullimit të realizuar në bazë të arkëtimeve, por jo më pak se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

c) lojërat elektronike dhe për video-lotarinë, të vendosura në mjediset e kazinosë, një taksë mujore në masën 25 për qind nga të ardhurat bruto nga lojërat e fatit;

ç) makinat slot me fitim në çast, një taksë mujore në masën 25 për qind nga të ardhurat bruto nga lojërat e fatit.

Krahas detyrimit tatimor të përmendur në pikat 2 dhe 4, të këtij neni, organizatorët e kategorive

“Kazino”, “Kazino në hotele me 5 vje” dhe “Resort kazino”, brenda 31 marsit të vitit pasardhës, derdhen në llogari të ministrisë përgjegjëse për turizmin shumën prej 0,2 për qind të xhiros vjetore dhe ministrisë përgjegjëse për kulturën shumën prej 0,2 për qind të xhiros vjetore. Ministrinë përgjegjëse duhet të njoftojnë AMLF-në në rast se organizatori nuk derdhet në llogaritë shumat e cilësuar në këtë pikë. Organizatori duhet të depozitojë kopje të mandatpagesës edhe pranë AMLF-së.

5. Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari Kazino në hotele me 5 vje, përveç detyrimeve të sipërcituara për këtë kategori, paguan dhe një taksë vjetore prej 140 000 (njëqind e dyzet mijë) lekësh për makinë elektronike.

6. Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojërave të fatit në bastet për gara në pistë, paguajnë detyrimet tatimore, si më poshtë:

a) një tatim loje fati, me kuotë fikse çdo muaj prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh për shoqërinë;

b) një tatim loje fati, me kuotë fikse çdo muaj prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për çdo pikë të shitjes së basteve;

c) për lojërat elektronike, me fitim në çast, të vendosura në mjediset e hipodromit, një tatim me kuotë fikse çdo muaj prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për çdo kompjuter elektronik ose pozicion të makinës elektronike.

7. Detyrimet tatimore për lojërat e fatit paguhen në degën e organeve tatimore, ku është e regjistruar shoqëria (organizatori), jo më vonë se data 15 e çdo muaji për veprimtarinë e realizuar në muajin pararendës.

8. Tatim-fitimi i organizatorit llogaritet dhe paguhet në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

9. Organizatori i kategorisë “Lotari Kombëtare”, brenda 31 marsit të vitit pasardhës, krahas detyrimeve të parashikuara në këtë nen, duhet të derdhë në llogari të Ministrisë së Financave 5 për qind xhiros vjetore si fond për çështjet e mira, si dhe 0,4 për qind të xhiros vjetore për ministrinë përgjegjëse për kulturën.

10. Organizatori i kategorisë “Bingo televizive”, brenda 31 marsit të vitit pasardhës, krahas detyrimeve të parashikuara në këtë nen, duhet të derdhë në llogari të ministrisë përgjegjëse për kulturën 0,2 për qind të xhiros vjetore.

11. Të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë taten sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat. Organizatorët e lojërave të fatit dhe kazinotë janë agjentë tatimorë për deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

12. Të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit të kategorisë “Baste sportive” dhe “Baste për gara në pistë”, ku fitimi i lojtarit nuk u nënshtrohet marzheve të fitimit të paracaktuara nga organizatori, nuk taten.

KREU XII

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 53

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji nga organizatori i lojërave të fatit, kur nuk përbëjnë veprë penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:

1.1. Gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, në rastet kur:

a) ka ndryshuar personeli i punësuar në shoqëri, pa njoftuar paraprakisht AMLF-në;

b) ka të punësuar, të pranishëm në mjediset e lojërave të fatit ose lojtarë nën moshën e lejuar, sipas dispozitave të këtij ligji;

c) rregulloret e lojërave të fatit nuk janë afishuar në mjediset e lojërave, në mënyrë të dukshme, në dispozicion të lojtarëve;

ç) në mjediset e lojërave të fatit nuk është ekspozuar informacioni paralajmërues për lojtarët për ndikimin negativ që mund të kenë këto lojëra në përputhje me pikën 1, të nenit 7, të këtij ligji;

d) vërehet mungesa ose mosfunksionimi i sistemit audio-viziv nga organizatorët e lojërave të fatit;

dh) subjekti, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pengon ushtrimin e kontrollit nga inspektorët e AMLF-së;

e) zhvillimi i lojës promovionale nga persona juridikë ose fizikë pa u pajisur me autorizimin për zhvillimin e lojërave promovionale nga drejtori i Përgjithshëm i AMLF-së;

ë) organizatori i lojërave të fatit nuk respekton ndalimet e parashikuara në nenet 6, 7 dhe 18, pika 5, të këtij ligji;

f) vërehet se organizatori ka shkelur kërkesat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

1.2. Ndaj organizatorit aplikohet gjobë në masën 1 000 000 (një milion) lekë, në rastet kur:

a) ushtrohet aktivitet lojërash fati dhe/ose tregtohen bileta të lojërave të fatit, duke mos respektuar vendodhjet dhe distancat, sipas ligjit dhe akteve nënligjore;

b) nuk sigurohen kontrolli, identifikimi dhe regjistrimi i lojtarëve, si dhe ruajtja e të dhënave të tyre identifikuese;

c) nuk lejohet, pengohet monitorimi *on-line* i subjekteve apo pajisjet nuk janë lidhur me sistemin e monitorimit *on-line* nga AMLF-ja apo është dëmtuar lidhja dhe sistemi i monitorimit;

ç) kryhet publicitet për lojëra fati, në kundërshtim me nenin 9, të këtij ligji;

d) të dhënat e depozituara nga shoqëria pranë Ministrisë së Financave, AMLF-së dhe autoritetit të autorizuar nuk përputhen me ato të konstatuara gjatë kontrollit;

dh) subjekti nuk bën deklaratimet periodike pranë AMLF-së dhe/ose vërehet se deklaratimet e bëra në AMLF-ja nuk përputhen me deklaratimet e bëra në organet tatimore;

e) pika nuk është e pajisur me NIUS sekondar ose nuk është regjistruar në përputhje me pikën 4, të nenit 18, të këtij ligji;

ë) pajisjet e lojërave të fatit nuk janë miratuar nga AMLF-ja dhe subjekti i ka vënë në përdorim;

f) subjekti/personi ushtron aktivitet të lojërave të fatit *on-line*, në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji;

g) personat fizikë ose juridikë, të cilët importojnë ose tregtojnë pajisjet e lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë, pa u autorizuar nga AMLF-ja.

gj) organizatorët që ushtrojnë aktivitetin e lojërave të fatit të basteve sportive përdorin programe *software* dhe *hardware*, të ndërtuara nga subjekte të paautorizuara nga AMLF-ja për këtë qëllim;

h) organizatori kundërshton, nuk respekton parashikimet e dispozitave të kreut X dhe/ose bllokun, heq, shkatërron ose çaktivizon pajisjet përkatëse të lojërave, të lidhura me SQMO, pajisjeve në lidhje me to apo të çdo pajisjeje ose *software* të lidhura me to;

i) të dhënat e nxjerra nga monitorimi *on-line* dhe ato faktike nuk përputhen me njëra-tjetrën;

j) ka mospërputhje të përmasave dhe formatit të reklamës me aktet nënligjore;

k) subjekti nuk ka paguar brenda afateve të parashikuara në ligj shumën 0,4 për qind të xhiros vjetore për ministrinë përgjegjëse për sportin, shumën prej 0,2 për qind të xhiros vjetore për ministrinë përgjegjëse për turizmin, shumën prej 0,2 për qind të xhiros vjetore për ministrinë përgjegjëse për kulturën, si dhe shumën prej 0,4 për qind të xhiros vjetore për ministrinë përgjegjëse për kulturën nga organizatori i lotarisë kombëtare.

l) organizatori, brenda periudhës së përcaktuar në pikën 6, të nenit 9, të këtij ligji, nuk ka marrë masat për ndryshimin e formatit dhe përmasave të reklamave sipas këtij udhëzimi.

2. Në rast përsëritjeje të shkeljeve të mësipërme, AMLF-ja bllokun dhe më pas heq të drejtën për ushtrim veprimtarie, si dhe ka të drejtë t'i kërkojë autoritetit të autorizuar nga ligji revokimin /pezullimin

dhe deri në heqjen e licencës.

3. Dënimi me gjobë për kundërvajtjet administrative vendoset nga inspektorët e AMLF-së.

4. Inspektori i AMLF-së, që vëren shkelje, harton procesverbalin për vendosjen e gjobës, të cilin ia komunikon organizatorit të lojës.

5. Ushtrimi i veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit, pa u licencuar, sipas procedurave të parashikuara nga ky ligj, kur nuk përbën veprer penale sipas parashikimeve të Kodit Penal, përbën kundërvajtje administrative dhe personi juridik, që kryen kundërvajtjen, dënohet me gjobë, si më poshtë:

a) për ushtrim aktiviteti bingo dhe/ose bingo televizive 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë;

b) për ushtrim aktiviteti “Lotari Kombëtare” 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë;

c) për ushtrim aktiviteti “Baste sportive” 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë;

ç) për ushtrim aktiviteti nëpërmjet makinave elektronike 1 000 000 (njëqind mijë) lekë për çdo makinë elektronike;

d) për ushtrim aktiviteti “Kazino” 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë;

dh) për ushtrim aktiviteti “Baste të garave në pista” 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë.

6. Në rast se kundërvajtja administrative kryhet nga persona fizikë, pa miratimin /licencën e organeve përkatëse, ky person dënohet me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

7. Organizatorit i konfiskohen pajisjet nga AMLF-ja kur:

a) kjo njësi vëren hapjen e pikave të reja pa njoftim dhe/ose licencim, pa NIUS dhe/ose NIUS sekondar;

b) veprimtaria është pezulluar/bllokuar dhe subjekti ushtron veprimtari të palejuar;

c) aktiviteti ushtrohet në kundërshtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

8. Pajisjet, që shërbejnë për lojëra fati, të cilat gjenden nga AMLF-ja në mjedise të padeklaruara pranë kësaj njësie, konfiskohen. Nëse është e pamundur që pronari/punonjësi të identifikohet, kjo e dhënë shënohet në aktin administrativ të konfiskimit.

9. Kur AMLF-ja vendos gjobë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, fleta e gjobës plotësohet në 3 kopje, nga të cilat njëra i dorëzohet subjektit/personit kundërvajtës, njëra depozitohet në AMLF dhe tjetra, depozitohet në Komisionin e Apelit të Gjobave, brenda 5 ditëve nga data e vendosjes së saj. Format i gjobës dhe të dhënat e saj miratohen me udhëzim të ministrit të Financave.

Neni 54

Ankimi administrativ ndaj gjobës

1. Ndaj dënimit me gjobë, organizatori, brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për procesverbalin e gjobës, ka të drejtën e ankimit administrativ, në Komisionin e Apelit të Gjobave.

2. Komisioni i Apelit të Gjobave përbëhet nga pesë anëtarë dhe një sekretar:

a) dy përfaqësues nga Ministria e Financave;

b) dy përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

c) një përfaqësues nga AMLF-ja.

3. Veprimtaria, mënyra, procedura e funksionimit të Komisionit të Apelit të Gjobave, procedurat e emërimit dhe të shkarkimit të anëtarëve, masa e shpërblimit të anëtarëve dhe sekretarit të Komisionit të Apelit të Gjobave përcaktohen me rregullore të miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Financave.

4. Ankimi ndaj masës së gjobës për kundërvajtje administrative përmban këto elemente:

a) emërtimin e personit/subjektit ankimues, numrin e NIUS-it, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe adresën e plotë;

b) objektin, për të cilin ushtron të drejtën e ankimit, duke përmendur të gjitha elementet identifikuese të masës ndëshkimore;

c) bazën ligjore të pretendimit për ankimin e tij;
ç) përshkrimin e përmbledhur të arsyeve, fakteve dhe rrethanave, për të cilat ankimohet masa ndëshkimore;

d) kërkesën përfundimtare;

dh) kopjen e procesverbalit të masës së gjobës, të vendosur nga inspektori;

e) të gjitha dokumentet provuese për pretendimet e tij.

5. Komisioni i Apelit të Gjobave merr vendim, brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit të ankimit, për lënie në fuqi ose jo të gjobës. Nëse Komisioni i Apelit të Gjobave nuk shprehet brenda 60 ditëve nga data e marrjes së ankimit, subjekti ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

6. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet në prani të kundërvajtësit. Kur vërtetohet se ai ka marrë dënim dhe nuk ka shkaqe justifikuese për mosparaqitje, shqyrtimi mund të bëhet edhe në mungesë.

7. Kundër vendimit të Komisionit të Apelit të Gjobave, secila nga palët, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, gëzon të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative, ku ka selinë subjekti i gjobitur, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në rastet kur kundërvajtësi është person fizik, ankimi bëhet në gjykatën e rrethit, ku është kryer kundërvajtja.

Neni 55

Ekzekutimi i gjobës

1. Gjobat paguhen nga kundërvajtësi brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit të Apelit të Gjobave ose, në rast apelimi, brenda 5 ditëve nga data kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet një kamatë prej 2 për qind e shumës deri në 30 ditë.

2. Nëse detyrimet nuk shlyhen në mënyrë vullnetare, ekzekutimi i tyre bëhet nga AMLF-ja, sipas procedurës së parashikuar për masat shtrënguese në këtë ligj.

Neni 56

Pezullimi i veprimtarisë dhe heqja e licencës

1. AMLF-ja pezullon për 30 ditë veprimtarinë për ushtrimin e lojërave të fatit dhe/ose propozon, pranë autoritetit të autorizuar, pezullimin e licencës së dhënë për lojëra fati, kur vëren se organizatori nuk shlyen detyrimet ndaj AMLF-së dhe/ose fituesve të lojës, deri në shlyerjen e plotë të tyre.

2. AMLF-ja konfiskon pajisjet e organizatorit të licencuar për lojërat e fatit, sipas ligjit, në rast se:

a) nuk zbaton ose shkel detyrimet e parashikuara në dispozitat e këtij ligji dhe në aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij;

b) ai nuk shlyen detyrimet e vendosura nga kjo njësi për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në këtë ligj;

c) licenca/miratimi është marrë në bazë të dokumenteve të rreme apo në kundërshtim me ligjin;

ç) gjatë afatit të pezullimit të veprimtarisë vazhdon të ushtrrojë aktivitetet në fushën e lojërave të fatit në kundërshtim me këtë akt;

d) në përfundim të afatit të pezullimit të licencës, ai nuk ka shlyer detyrimet ligjore, për të cilën i është pezulluar licenca.

3. Organizatorit për zhvillim të lojërave të fatit i hiqet licenca për zhvillim aktiviteti në rastet kur:

a) për të paktën 6 muaj nuk ka zhvilluar aktivitetet ose nuk ka bërë pagesat përkatëse dhe/ose deklaratimet pranë AMLF-së dhe/ose organit tatimor;

b) ka pezulluar prej të paktën 1 viti aktivitetin pranë organeve përkatëse;

c) është konstatuar nga AMLF-ja se ushtron aktivitetet të paregjistruar në QKR apo të pamiruar

nga AMLF-ja dhe pas marrjes së një mase administrative me gjobë ose konfiskim;

ç) është konstatuar se ka makineri të padeklaruara pranë AMLF-së, në mënyrë të përsëritur dhe janë marrë paraprakisht disa masa administrative;

d) është konstatuar se makinat që përdoren për ushtrim të aktivitetit të lojërave të fatit nuk janë të lidhura me Sistemin Qendor të Monitorimit On-line të AMLF-së, në mënyrë të përsëritur dhe janë marrë paraprakisht disa masa administrative;

dh) subjekti është licencuar në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi;

e) ortaku/aksionari dhe administratori përfshi-hen në kryerjen e veprave penale të parashikuara në dispozitat e këtij ligji.

4. Në rast se një subjekti i është hequr licenca për ushtrimin e aktivitetit në fushën e lojërave të fatit ose i ka mbaruar licenca dhe subjekti rezulton si debitor karshi institucioneve shtetërore, ky subjekt, ortakët/aksionarët e tij, përfaqësuesit e tyre ligjorë apo anëtarë të organeve të tjera drejtuese të subjektit nuk kanë të drejtë të aplikojnë për një afat prej 10 vjetësh për t'u pajisur me licencë në fushën e lojërave të fatit dhe as të jenë ortakë/aksionarë administratorë apo anëtarë në ndonjë nga organet drejtuese të subjektit që do të pajiset me licencë.

Neni 57

Bashkëpunimi i AMLF-së me strukturat e tjera shtetërore

1. Për zbatimin e detyrave ligjore, me kërkesën e saj, AMLF-ja mbështetet nga strukturat e Policisë së Shtetit. Mënyra e bashkëveprimit dhe e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit përcaktohen në marrëveshjen e përbashkët që lidhet midis drejtorit të Përgjithshëm të AMLF-së dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me strukturat në varësi të saj, për subjektet që zhvillojnë veprimtari për lojëra fati, janë të detyruara të paraqesin të gjitha deklaratimet mujore, sipas sallave të deklaruara nga subjektet, dhe ndryshimet periodike, pranë AMLF-së. Mënyra e bashkëveprimit dhe e bashkëpunimit me administratën tatimore përcaktohen në marrëveshjen e përbashkët që lidhet midis drejtorit të Përgjithshëm të AMLF-së dhe drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

3. Hapja dhe mbyllja e sallave ku zhvillohet aktivitet për lojëra fati, për efekte regjistrimi apo të tjera, bëhen nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit pas plotësimit të dokumentacionit përkatës dhe vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga AMLF-ja, sipas dispozitave të këtij ligji për hapjen/mbylljen e sallave të lojërave të fatit.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton rregullisht AMLF-në, sa herë që zhdoganohen pajisje ose pjesë këmbimi që shërbejnë apo mund të shërbejnë për kryerjen dhe organizimin e lojërave të fatit. AMLF-ja i dërgon drejtorit të Përgjithshëm të Doganave listën e personave të pajisur me autorizim për importim dhe rast pas rasti njofton këtë drejtori për ndryshime apo shtesa të mundshme në këtë listë.

5. Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, për realizimin sa më efektiv të funksioneve dhe kompetencave ligjore lidhur me mbikëqyrjen e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e lojërave të fatit, në varësi të çështjes që shtrohet për zgjidhje, bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe me institucione të tjera qendrore.

Neni 58

Procedurat e zhdoganimit të pajisjeve për lojëra fati dhe pjesëve të këmbimit të tyre

1. Të gjitha mjetet e lojërave të fatit, të cilat do të përdoren për zhvillim aktiviteti në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësojnë detyrimisht specifikimet teknike, siç janë parashikuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Lejohen të importojnë mjete për lojëra fati, për qëllime tregtare, vetëm ata organizatorë, të cilët kanë marrë miratimin për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit nga

organi përkatës.

3. Lejohen të importojnë pajisje për lojëra fati, me qëllime të ndryshme nga ato tregtare (si p.sh. për qëllime muzeale, ekspozimi, panairësh etj.), vetëm importuesit, të cilët kanë marrë miratimin paraprak nga AMLF-ja. Në kërkesën e subjektit për miratim duhet të specifikohen, ndër të tjera, numri, tipi dhe qëllimi i përdorimit të mjeteve të lojërave të fatit. Ngarkohet me përgjegjësi importuesi dhe/ose përdoruesi nëse këto pajisje përdoren për qëllime të ndryshme nga ato të deklaruarat.

4. Të gjitha pjesët e këmbimit, elektronike apo mekanike, që shërbejnë apo mund të shërbejnë për riparimin apo zëvendësimin e pjesëve ekzistuese, u nënshtrohen të njëjtave procedura zhdoganimi si mjetet e lojërave të fatit.

5. Ngarkohet ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimit për përcaktimin e procedurave të zhdoganimit të pajisjeve për lojëra fati dhe pjesëve të këmbimit të tyre, si dhe mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet AMLF-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Neni 59

Masat shtrënguese

1. Kur Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit vëren shkelje të detyrimeve ndaj AMLF-së, të parashikuara në këtë ligj nga subjektet e licencuara për ushtrim të aktivitetit për lojëra fati, 30 ditë pas datës së dërgimit të njoftimit subjektit përkatës, merr masat e mëposhtme shtrënguese, si më poshtë:

a) pezullimin për një periudhë 30-ditore të veprimtarisë. Pezullimi nuk e ndalon pagesën e detyrimeve tatimore të mbledhura apo shlyerjen e detyrimeve të tjera të organizatorit;

b) bllokimin e llogarive bankare deri në shlyerjen e detyrimit ligjor, për të cilin është marrë masa e pezullimit të veprimtarisë;

c) konfiskimin e mjeteve të lojërave, magazinimin, si dhe shkatërrimin e tyre, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj;

ç) heqjen e lejes për ushtrim aktiviteti ose propozimin për heqjen e lejes/licencës së ushtrimit të aktivitetit organit që e ka lëshuar atë;

d) sekuestrimin e pasurive të regjistruara në emër të subjektit.

2. Ndaj personave që ushtrojnë aktivitet për lojëra fati në kundërshtim me këtë ligj, të cilët nuk janë të pajisur me licencë, do të aplikohen masat e mësipërme shtrënguese për aq sa janë të aplikueshme.

3. Shkronjat “a” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni, zbatohen nga AMLF-ja edhe në rastet kur subjektet e lojërave të fatit rezultojnë debitorë në administratën tatimore, sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Procedurat për zbatimin e kësaj dispozite, për efekt të detyrimeve tatimore, fillojnë të zbatohen nga AMLF-ja, brenda 15 ditëve pas njoftimit me shkrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Neni 60

Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të subjektit

Nëse subjekti nuk paguan detyrimet e përcaktuara sipas këtij ligji, nëpërmjet një urdhri me shkrim të drejtorit të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, i kërkohet çdo banke, ku subjekti ka llogari në emër të vet, të bllokojë një shumë, e cila duhet të jetë më e vogla ndërmjet:

a) shumës që kërkohet të mbahet;

b) shumës që rezulton në atë çast në llogarinë bankare të tatimpaguesit.

Neni 61

Masat e sigurimit të detyrimit

1. Nëse subjekti nuk paguan detyrimin brenda afateve të caktuara, sipas këtij ligji, detyrimi

sigurohet në favor të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, mbi të gjithë pasurinë e subjektit, në masën e nevojshme për të përmbushur detyrimin e tij.

2. Masa e sigurimit të detyrimit të papaguar mund të jetë, sipas rastit, barrë siguroese dhe/ose barrë hipotekore. Vendimi për të vendosur një barrë siguroese dhe/ose barrë hipotekore mbi pasurinë e subjektit bëhet me shkrim nga drejtori i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

3. Para vendosjes së një barre siguroese dhe/ose barre hipotekore mbi pasurinë e subjektit, ky i fundit duhet të njoftohet me shkrim. Njoftimi duhet të përmbajë të gjithë informacionin për to.

4. Njoftimi mbi barrën siguroese dhe/ose barrën hipotekore duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme për të identifikuar subjektin, detyrimin e papaguar, pasurinë, objekt të barrës siguroese dhe/ose barrës hipotekore, si dhe kompetencën e Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për të dorëzuar kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit.

5. Format i njoftimit për masën siguroese dhe/ose barrën hipotekore dhe regjistrat publikë për regjistrimin e tyre parashikohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 62

Ankimi i masës së sigurimit të detyrimit

1. Subjekti ka të drejtë të ankimojë vendimin për masën e sigurimit të detyrimit të papaguar tek drejtori i AMLF-së dhe të kërkojë çlirimin nga sigurimi, vetëm kur ai është ekzekutuar në mënyrë të parregullt. Ankimimi bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga çasti i marrjes dijeni për këtë parregullsi.

2. Kur kërkesa e subjektit miratohet nga drejtori i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, ndërmerren menjëherë të gjitha masat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi për zhbllokimin e masës së sigurimit mbi pasurinë e subjektit. Vendimi futet në dosjen e subjektit.

3. Nëse drejtori i autoritetit nuk e miraton kërkesën, subjekti mund ta ankimojë vendimin, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 63

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë

1. Nëse subjekti nuk paguan detyrimin, sipas afatit të përcaktuar në këtë ligj, Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit mund ta mbledhë detyrimin e papaguar nëpërmjet fondit të garancisë për AMLF-në. Në rast se detyrimet e subjektit nuk shlyhen me fondin e garancisë, atëherë procedohet me sekuestrimin e më pas me konfiskimin e pasurisë së siguruar në favor të Autoritetit, në pronësi të subjektit të detyruar.

2. Ekzekutimi i masës së sigurimit, nëpërmjet sekuestrimit, konfiskimit dhe shitjes së pasurisë, sipas këtij kreu, është objekt i dispozitave të ligjit “Për kundërvajtjet administrative” dhe realizohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

3. Urdhri për sekuestrimin e pasurisë bëhet me shkrim nga drejtori i Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit. Urdhri duhet të identifikojë subjektin, pasuria e të cilit është objekt sekuestrimi, vendndodhjen e pasurisë dhe vlerësimin e detyrimit, për të cilin vihet sekuestroja. Urdhri i dërgohet subjektit me postë rekomande.

4. Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit mund të sekuestrojë pasurinë, sipas detyrimit, vetëm pas vendosjes së masës së sigurisë mbi pasurinë, në përputhje me këtë ligj dhe vetëm 30 ditë kalendarike pas datës kur urdhri i sekuestrimit është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga subjekti në formën e parashikuar nga ky ligj.

5. Në rast se subjekti debitor, pas 30 ditëve kalendarike nga vendosja e sekuestros mbi pasurinë e tij, nuk paguan detyrimet, AMLF-ja, me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm, vendos konfiskimin e pasurisë së sekuestruar.

Neni 64
Urdhri i sekuestrimit

1. Urdhri i sekuestrimit përmban:

- a) shumën e detyrimeve të papaguara;
- b) afatin për pagesën e detyrimeve;
- c) pasurinë që sekuestrohet;
- ç) informacionin për të drejtën e subjektit për ankim administrativ.

2. Nëse objekti i sekuestrimit është paga e subjektit, urdhri përfshin edhe emrin dhe adresën e punëdhënësit të subjektit.

3. Nëse sekuestrimi bëhet për shkak të shkeljes së masës së bllokimit, zbatohet menjëherë dhe prek vetëm sendet, të cilat përdoren për zhvillimin e paligjshëm të lojërave të fatit.

Neni 65
Pasuria, objekt i sekuestrimit

Objekt sekuestrimi është e gjithë pasuria e subjektit, në masën e detyrimit të papaguar, përveç sendeve të përcaktuara në nenin 529 të Kodit të Procedurës Civile.

Neni 66
Shitja e pasurisë së konfiskuar

1. Pasuria e sekuestruar, pasi konfiskohet në përputhje me pikën 5, të nenit 63, të këtij ligji, shitet në ankand publik, i cili kryhet në përputhje me procedurat dhe kushtet e parashikuara në ligjin “Për ankandin publik”.

2. Të ardhurat nga shitjet përdoren fillimisht për të paguar shpenzimet e shitjes, më pas për të paguar koston administrative, gjobat dhe interesin, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

3. Shuma e mbetur i kthehet subjektit, brenda pesë ditëve pune nga data e përfundimit të ankandit.

Neni 67
Përgjegjësia e ortakut, aksionarit dhe përfaqësuesit ligjor

1. Nëse edhe pas shitjes së pasurisë së konfiskuar, detyrimet e personit juridik nuk shlyhen plotësisht, atëherë AMLF-ja, në përputhje me legjislacionin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, kërkon transferimin e detyrimit të mbetur për llogari të ortakut, aksionarit dhe administratorit përgjegjës.

2. Administratori, ortakët apo aksionarët janë solidarisht përgjegjës për detyrimin e papaguar të personit juridik ndaj AMLF-së.

3. Rregullat e parashikuara në pikat 1 e 2, të këtij neni, për transferimin e detyrimit vlejnë edhe për rastet kur fillojnë procedurat e likuidimit apo falimentimit të tatimpaguesit dhe shoqëria tregtare ka ende të pashlyer detyrimin karshi AMLF-së.

Neni 68
Pajisja me armë e inspektorëve

1. Inspektorët e Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit kanë të drejtë të pajisen me armë zjarri në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi.

2. Miratimi i lejes jepet nga Ministria e Brendshme, vetëm pas autorizimit të lëshuar nga Ministria

e Financave për përcaktimin e inspektorëve dhe të llojit të armatimit.

Neni 69

Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në veprimtarinë e lojërave të fatit

1. Organizatorët e lojërave të fatit, përfshirë në këtë ligj, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje edhe me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, veçanërisht në rastet e verifikimit të lojtarëve, identifikimit të pronarit përfitues dhe identifikimin e klientëve, identifikimit dhe raportimit të transaksioneve të dyshimta dhe termave për ruajtjen e informacionit të lojtarëve.

2. Organizatorët e lojërave të fatit janë të detyruar, në të gjitha rastet, të verifikojnë lojtarët dhe të bëjnë raportimet përkatëse në përputhje me ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 70

Nxjerrja e akteve nënligjore

(ndryshuar pika 2 dhe afati në të gjithë nenin, me ligjin nr. 140/2016, datë 22.12.2016)

1. Rregullat e mbajtjes dhe funksionimit të regjistrit identifikues të lojtarëve të parashikuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 6, të këtij ligji, si dhe kategoritë e subjekteve që detyrohen të mbajnë dhe të përditësojnë regjistrin e lojtarëve, miratohen nga AMLF-ja, brenda datës 31 janar 2017.

2. Formatit dhe përmasat e tabelave identifikuese në pjesën e jashtme të pikave/sallave të ofrimit të lojërave të fatit për çdo kategori përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave që miratohet brenda datës 31 janar 2017.

3. Kushtet, dhe kërkesat teknike që duhet të plotësojë subjekti që do të licencohet për kategorinë “Lojëra elektronike në distancë” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave brenda datës 31 janar 2017.

4. Shtypja dhe prodhimi i biletave për lojëra fati, formati dhe mënyra e emetimit të biletës *on-line* apo forma të tjera të pranimit të pjesëmarrjes në lojën *on-line*, bëhen në përputhje me procedurat, afatet dhe formatet e miratuara me udhëzim të ministrit të Financave, sipas llojit të lojës për të cilën do të përdoren, brenda datës 31 janar 2017.

5. Mënyrat, format, kriteret dhe rregullat për organizimin e lojërave të fatit promovionale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit të Financave, brenda datës 31 janar 2017.

6. Procedurat e shitjes, lënies peng, dhurimit si dhe çdo formë tjetër e disponimit të aksioneve, aseteve, pasurisë apo makinave të organizatorit të lejuar për zhvillimin e lojërave të fatit përcaktohen me udhëzim të ministrit të Financave, që miratohet brenda datës 31 janar 2017.

7. Rregullat, procedurat, afatet dhe specifikimet teknike të mekanizmave të fiskalizimit e të monitorimit të lojërave të fatit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, brenda datës 31 janar 2017.

8. Kushtet dhe standardet minimale që duhet të plotësojnë pikat e basteve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, që miratohet brenda datës 31 janar 2017.

9. Standardet që kanë të bëjnë me kushtet teknike të sistemit të basteve nëpërmjet kanaleve të shitjeve interaktive *on-line*, duke përfshirë identifikimin dhe regjistrimin e lojtarëve, kërkesat e programeve *software* dhe *hardware*, certifikimin e sistemit, procedurat në lidhje me faturat dhe transaksionet e pagesave, parimet e sigurisë, kushtet e kontrollit, parimet e organizatës përgjegjëse, etj., përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, i cili miratohet brenda datës 31 janar 2017.

10. Përcaktimi i distancave nga territori administrativ i njësisë vendore për vendosjen e kazinove

miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave brenda datës 31 janar 2017.

11. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të Financave, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, vendos minimumin e specifikimeve teknike dhe dokumentacionin shoqërues që duhet të kenë pajisjet e lotarisë, bingo televizive dhe pajisjet e lojërave *live* në kazino.

12. Kushtet teknike të SQMO të lojërave të fatit, afatet maksimale të implementimit të projektit, tarifa e mirëmbajtjes së tij që duhet të paguajnë shoqëritë e licencuara, si dhe çdo çështje tjetër që ka lidhje me sistemin e monitorimit *on-line* miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, brenda datës 31 janar 2017.

13. Mënyra e funksionimit të Komisionit të Apelimit të Gjobave, procedurat e tij operative, procedurat e emërimit dhe e shkarkimit të anëtarëve dhe mënyra e shpërblimit të tyre përcaktohen me rregullore të nxjerrë me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, brenda datës 31 janar 2017.

14. Ngarkohet Ministria e Financave që, brenda datës 31 janar 2017, të nxjerrë udhëzim për përcaktimin e procedurave të zhdoganimit të pajisjeve për lojëra fati dhe pjesëve të këmbimit të tyre, si dhe mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet AMLF-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

15. Procedura që do të ndiqet, formati i njoftimit për masën siguruese dhe/ose barrën hipotekore dhe regjistrat publikë për regjistrimin e tyre parashikohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, brenda datës 31 janar 2017.

16. Mënyra e përlogaritjes së distancave nga institucionet e parashikuara në pikën, 2 të nenit 7, dhe nenit 18/5, pika 2, miratohet me udhëzim të Ministrit të Financave brenda datës 31 janar 2017.

KREU XIII DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 71

Dispozita kalimtare

(ndryshuar pika 2 dhe 3 me ligjin nr. 140/2016, datë 22.12.2016)

1. Organizatorët e lojërave të fatit “Kazino” dhe “Lotari Kombëtare”, të licencuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtrojnë aktivitetin në përputhje me afatin e licencimit të parashikuar në licencën përkatëse.

2. Organizatorët e kazinove elektronike dhe bingo tradicionale, të cilat janë licencuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë të drejtë të ushtrojnë aktivitetin vetëm në pikat që janë hapur në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri në datën 31 dhjetor 2018. Gjatë kësaj periudhe tranzitore nuk lejohet hapja e pikave të reja sekondare për ushtrimin e aktivitetit nga shoqëritë e licencuara për kazino elektronike dhe bingo tradicionale. Pikat që mbyllen për këto kategori gjatë periudhës tranzitore nuk mund të rihapen.

3. Organizatorëve të kategorive “Baste sportive”, “Baste për garat në pistë” dhe “Bingo televizive”, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, u fillon afati i vlefshmërisë së licencës, sipas kategorisë përkatëse, dhe janë të detyruar të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre, të paguajnë tarifën përkatëse të licencimit, sipas dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, deri më 31 dhjetor 2018.

4. Licenca e organizatorit, i cili nuk përshtatet me dispozitat e këtij ligji, sipas pikave 1, 2 dhe 3, të këtij neni, konsiderohet e pavlefshme.

5. Dispozitat e këtij ligji janë të aplikueshme deri në masën që nuk bien ndesh me licencat e subjekteve që disponojnë licencë për “Lotari Kombëtare” dhe “Kazino”.

6. Nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri në fillimin e taksimit të shoqërive të lojërave të fatit mbi bazën e SQMO, shoqëritë e licencuara në fushën e lojërave të fatit derdhen në llogari të AMLF-së, 0,5 për

qind të xhiros vjetore, por jo më pak se:

a) 4 000 000 (katër milionë) lekë në vit për shoqëritë e licencuara për “Kazino” dhe “Lotari Kombëtare”;

b) 3 000 000 (tre milionë) lekë në vit për shoqëritë që organizojnë “Kazino elektronike”, si dhe “Lojërat elektronike në distancë”;

c) 2 000 000 (dy milionë) lekë në vit për shoqëritë që organizojnë “Baste sportive” dhe “Baste për gara në pistë”;

ç) 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë në vit për shoqëritë që organizojnë “Bingo televizive”.

7. Implementimi i SQMO dhe fillimi i taksimit të shoqërive të lojërave të fatit mbi bazën e këtij sistemi do përcaktohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën tranzitore nga hyrja në fuqi e këtij ligji deri në fillimin e zbatimit të Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line*, detyrimet periodike ndaj AMLF-së, detyrimet tatimore si dhe çdo detyrim tjetër, do vazhdojnë të llogariten dhe paguhën si më poshtë:

Neni 72

Detyrimet tatimore

(shfuqizuar paragrafi i fundit i pikës 4.2 dhe shtuar pika 7 pas pikës 6 me ligjin nr. 140/2016, datë 22.12.2016)

1. Fitimet që organizatori i lojërave të fatit realizon nga ushtrimi i veprimtarisë së tij janë të tatueshme, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë taten sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat. Organizatorët e lojërave të fatit dhe kazinotë janë agjentë tatimorë për deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në bazë të dispozitave të legjislacionit tatimor në fuqi.

3. Veprimtaritë e lojërave të fatit, që taten sipas dispozitave të këtij ligji, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

4. Detyrimet tatimore janë:

4.1. Për bingo:

a) Organizatori i lojës bingo, që zhvillohet për pjesëmarrës, brenda sallës, paguan një tatim për lojërat e fatit, me një kuotë fikse, çdo muaj, për çdo sallë, përkatësisht, 500 000 lekë për rrethet e kategorisë së parë, 400 000 lekë për rrethet e kategorisë së dytë dhe 300 000 lekë për rrethet e kategorisë së tretë;

b) Organizatori i lojës bingo televizive, që nuk zhvillohet për pjesëmarrës brenda sallave, paguan tatim për lojërat e fatit 10 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, gjithsej, të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave. Organizatori, për çdo lojë, duhet t’u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë.

4.2. Për bastet sportive:

Organizatori i basteve sportive paguan tatim për lojërat e fatit 25 për qind mbi fitimin nga loja, por jo më pak se:

a) për 1 deri në 99 NIPTE, 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë në muaj, për çdo shoqëri që kryen këtë veprimtari;

b) për 100 deri në 149 NIPTE, 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë në muaj, për çdo shoqëri që kryen këtë veprimtari;

c) mbi 150 NIPTE, 14 000 000 (katëmbëdhjetë milionë) lekë në muaj, për çdo shoqëri që kryen këtë veprimtari. Organizatori duhet t’u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë.

Përveç pagesave të shoqërisë, për çdo pikë basti, duhet të kryhen pagesat në tarifa fikse mujore, si më poshtë:

- a) për rrethet e kategorisë së parë, 40 000 (dyzet mijë) lekë;
- b) për rrethet e kategorisë së dytë, 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;
- c) për rrethet e kategorisë së tretë, 20 000 (njëzet mijë) lekë.

4.3. Për kazino elektronike:

Organizatori i lojërave për kazino elektronike paguan tatim mujor mbi lojërat e fatit 4 për qind mbi vëllimin e qarkullimit të realizuar në bazë të arkëttimeve, për por jo më pak se:

- a) për rrethet e kategorisë së parë, 400 000 (katërqind mijë) lekë për çdo sallë dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot e videolotari;
- b) për rrethet e kategorisë së dytë, 200 000 (dyqind mijë) lekë për çdo sallë dhe 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot e videolotari;
- c) për rrethet e kategorisë së tretë, 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo sallë dhe 40 000 (dyzet mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot e videolotari;
- ç) për çdo makinë elektronike me më shumë se një pozicion (ruletë) organizatori paguan një kuotë fikse mujore prej 1 000 000 (një milion) lekë dhe 300 000 lekë në muaj për çdo pozicion loje, pavarësisht nga rrethi ku ushtron veprimtarinë. Organizatori duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 80 për qind të shumës së vënë në lojë.

4.4. Për lojërat e fatit të kategorisë “Lotari Kombëtare”:

Organizatori i lojërave, të përfshira në licencën për kategorinë “Lotari Kombëtare” paguan tatim për lojërat e fatit, 10 për qind mbi vëllimin e qarkullimit gjithsej. Për çdo lotari, organizatori duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 50 për qind të shumës së vënë në lojë. Për rastet kur shuma në dispozicion të lojtarëve nuk u shpërmdahet fituesve, ajo mbartet në lotarinë pasardhëse, si shumë në dispozicion të lojtarëve.

4.5 Për lojërat e fatit të kategorisë “Lojëra elektronike në distancë”:

Deri në implementimin e SQMO, subjektet që ushtrojnë aktivitet “Lojëra elektronike në distancë” do të monitorohen nga AMLF-ja nëpërmjet sistemit të tyre elektronik, duke i ofruar AMLF-së aksesin në këtë sistem. Ky sistem duhet të bëjë të mundur që në çdo kohë AMLF-ja të gjenerojë raporte nga sistemi i subjektit, mbi xhirot, fitimet, pjesëmarrësit në lojë dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm. Kërkesat teknike për ngritjen dhe lidhjen e këtij sistemi me AMLF-në dhe DPT-në dhe informacioni që duhet të gjenerohet dhe arkivohet me këtë sistem do të përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Financave.

Në çdo rast, deri në implementimin e SQMO, subjekti duhet të paguajë tatimin mujor mbi lojërat e fatit në masën 1,5 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, në bazë të arkëttimeve, por jo më pak se 7 000 000 (shtatë milionë) lekë. Organizatori duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 90 për qind të shumës së vënë në lojë.

5. Për efekt të këtij ligji, në rrethet e kategorisë së parë përfshihen Tërana dhe Durrësi, në rrethet e kategorisë së dytë përfshihen: Shkodra, Korça, Vlora, Saranda, Gjirokastra, Elbasani, Fieri, Lushnja, Pogradeci, Berati, Lezha e Kavaja, ndërsa në rrethet e kategorisë së tretë përfshihen të gjitha rrethet e tjera.

6. Detyrimet tatimore për lojërat e fatit, në përqindje apo në shumë fikse, paguhen në degën e tatim-taksave, ku është e regjistruar shoqëria (organizatori), jo më vonë se data 15 e çdo muaji për veprimtarinë e realizuar në muajin pararendës.

7. Organizatorët e lojërave të fatit, sipas kategorive përkatëse, derdhin në llogari të ministrisë përgjegjëse për sportin, ministrisë përgjegjëse për kulturën dhe ministrisë përgjegjëse për turizmin shumat përkatëse, sipas parashikimeve të nenit 52 të këtij ligji.

Detyrimi tatimor për kazinotë

1. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

Të ardhurat e individëve nga kazinotë taten sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat. Organizatorët e kazinosë janë agjentë tatimorë për deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojërave të fatit në kazino, paguajnë detyrimet tatimore mujore, si më poshtë:

a) për tryezat me më shumë se një pozicion (ruletë), një taksë mujore në masën 12 për qind mbi vëllimin e qarkullimit të realizuar në bazë të arkëtimeve, por jo më pak se 300 000 (treqind mijë) lekë në muaj për çdo pozicion;

b) për çdo tryezë të lojërave (me letra dhe/ose me zare), një taksë mujore në masën 12 për qind mbi vëllimin e qarkullimit të realizuar në bazë të arkëtimeve, por jo më pak se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

c) për lojërat elektronike dhe për videlotarinë, të vendosura në mjediset e kazinosë, një taksë mujore në masën 4 për qind për qind mbi vëllimin e qarkullimit të realizuar në bazë të arkëtimeve, por jo më pak se 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për çdo kompjuter elektronik;

ç) për makinat slot me fitim në çast, një taksë mujore në masën 4 për qind mbi vëllimin e qarkullimit të realizuar në bazë të arkëtimeve, por jo më pak se 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për çdo kompjuter elektronik.

3. Brenda datës 10 të muajit pasardhës, organizatori i lojërave të fatit derdh në llogari të bashkisë apo komunës ku zhvillon veprimtarinë për kazino 0,2 për qind të xhiros.

4. Organizatori duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 80 për qind të shumës së vënë në lojë.

Neni 74

Detyrimi tatimor për bastet për gara në pistë

1. Tatim-fitimi i shoqërisë (organizatorit) llogaritet dhe paguhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Të ardhurat e individëve nga bastet për gara në pistë taten sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat. Organizatorët e basteve për gara në pistë janë agjentë tatimorë për deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat e individëve nga lojrat e fatit, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për tatimin mbi të ardhurat dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari në fushën e organizimit të lojërave të fatit në bastet për gara në pistë, paguajnë detyrimet tatimore, si më poshtë:

a) një tatim loje fati, me kuotë fikse, çdo muaj, prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për shoqërinë;

b) një tatim loje fati, me kuotë fikse, çdo muaj, prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh, për çdo pikë të shitjes së basteve;

c) për lojërat elektronike, me fitim në çast, të vendosura në mjediset e hipodromit, një tatim me kuotë fikse, çdo muaj, prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh, për çdo kompjuter elektronik ose pozicion të makinës elektronike.

3. Brenda datës 10 të muajit pasardhës, organizatori i lojërave të fatit derdh në llogari të bashkisë ku zhvillon veprimtarinë për baste me gara në pistë 0,2 për qind të xhiros.

Neni 75
Shfuqizime

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 10 033, datë 11.12.2008, “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 10 033, datë 11.12.2008, “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji.

Neni 76
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.12.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9402, datë 15.1.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**